**Komuna e Gjilanit**
Opstina Gnjilane – Municipality of Gjilan
*Komuna – Opstina – Municipality*
Zyra e Kryetarit

# Raporti i Punës Janar-Qershor 2023

# Përmbajtja


1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME ..... 3
2. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE ..... 10
3. DREJTORIA E ARSIMIT ..... 21
4. DREJTORIA BUXHET DHE FINANCA ..... 29
5. DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT ..... 31
6. DREJTORIA E INSPEKCIONIT ..... 38
7. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI ..... 42
8. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM ..... 45
9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË ..... 50
10. DREJORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM ..... 53
11. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK ..... 64
12. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT ..... 75

NJËSIA E KUVENDIT ..... 77

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT ..... 80

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË KOMUNËN E GJILANIT ..... 83

ZYRA LIGJORE ..... 87

ZYRA PËR INFORMIM ..... 89

ZYRA KOMUNALE PËR INTEGRIME EVROPIANE ..... 89

ZYRA E PROKURIMIT ..... 90

## 1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

**Sektori i Gjendjes Civile**

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (DAP), bazuar në Planin e Punës për vitin 2023, objektiv kryesor ka mbarëvajtjen dhe zhvillimin e administratës publike komunale, përmes reformimit të sistemit administrativ, me qëllim që qytetarëve t'iu ofrohet qasje e barabartë në shërbime administrative.

Në kuadër të DAP-it funksionon Sektori i Gjendjes Civile, Qendra për Shërbime me Qytetarë, Shërbimi i Autoparku dhe Shërbimi i TI-së.

**Dokumentet e gjendjes civile**

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, kemi lëshuar gjithsej: **57,820 dokumente të gjendjes civile**, respektivisht 28,374 dokumente të gjendjes civile për përdorim të brendshëm dhe 29,446 dokumente të gjendjes civile për përdorim të jashtëm.

Bashkangjitur tabelat me listën e dokumenteve të lëshuara:

| **Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile – për përdorim të brendshëm** | | | |
|---|---|---|---|
| Komuna | | Data prej | Data deri |
| Gjilan | | 01.01.2023 | 30.06.2023 |
| Lloji i dokumentit dhe numri i dokumenteve të lëshuara | | | |
| Certifikatë e lindjes | | | 1583 |
| Ekstrakt i lindjes | | | 18292 |
| Certifikatë e shtetësisë | | | 191 |
| Certifikatë e martesës | | | 2712 |
| Certifikatë e vdekjes | | | 1620 |
| Certifikatë vendbanimi | | | 444 |

| | |
|---|---|
| Certifikatë e gjendjes martesore | 814 |
| Deklaratë e bashkësisë familjare | 1756 |
| Vërtetim nga Arkivi | 962 |
| **Totali:** | **28374** |

| **Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile – për përdorim të jashtëm** | | | |
|---|---|---|---|
| Komuna | | Data prej | Data deri |
| Gjilan | | 01.01.2023 | 30.06.2023 |

| Lloji i dokumentit dhe numri i dokumenteve të lëshuara | |
|---|---|
| Certifikatë e lindjes | 12144 |
| Ekstrakt i lindjes | 3844 |
| Certifikatë e shtetësisë | 248 |
| Certifikatë e martesës | 4185 |
| Certifikatë e vdekjes | 629 |
| Certifikatë vendbanimi | 1568 |
| Certifikatë e gjendjes martesore | 498 |
| Deklaratë e bashkësisë familjare | 5424 |
| Vërtetim nga Arkivi | 906 |
| **Totali:** | **29446** |

Të tjera:

| | |
|---|---|
| Aplikime për fitimin e shtetësisë | 84 |
| Aplikime për lirimin nga shtetësia | 26 |
| Anulime | 1 |
| **Totali:** | **111** |

**Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative**

Ashtu siç është e paraparë me legjislacionin në fuqi, në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, zhvillohen procedura të caktuara administrative.

Bashkangjitur tabela me llojet e dokumenteve/procedurave të zhvilluara:

| Veprimet/Procedurat e zhvilluara administrative | | | |
|---|---|---|---|
| Komuna | | Data prej | Data deri |
| Gjilan | | 01.01.2023 | 30.06.2023 |
| Lloji i dokumentit dhe numri | | | |
| Lindje të rregullta, brenda dhe jashtë vendit | | | 819 |
| Lindje të regjistruara me vonesë, brenda dhe jashtë vendit | | | 100 |
| Verifikime me numër personal paraprak dhe me gjenerim të numrit personal | | | 173 |
| Rishkrime të lindjes | | | 101 |
| Regjistrim i qytetarit me vendim të komisionit për shtetësi, me nenin 31, me dekret të Presidentit, me nenin 32 dhe me vendim 296/2018 | | | 58 |
| Martesat e rregullta dhe jashtë vendit | | | 448 |
| Rishkrim martese brenda dhe jashtë vendit | | | 183 |
| Shkurorëzime | | | 36 |
| Anulime teknike | | | 1 |
| Martesa me element të huaj | | | 126 |
| Martesa me vendim 296/2018 | | | 0 |
| Vdekjet e rregullta, brenda dhe jashtë vendit | | | 323 |
| Vdekje të regjistruara me vonesë, brenda dhe jashtë vendit | | | 44 |

| | |
|---|---|
| Rishkrim vdekje | 0 |
| Regjistrim i qytetarit të vdekur | 126 |
| Me vendim 296/2018 | 0 |
| **Totali** | **2538** |

**Qendra për Shërbime me Qytetarë (QSHQ)**
Në kuadër të QSHQ-së në vazhdimësi janë pranuar kërkesat e qytetarëve të cilat janë përcjell në Drejtoritë përkatëse, si dhe pas marrjes së përgjigjeve për lëndët e shqyrtuara nga Drejtoritë, janë njoftuar qytetarët përmes SMS-ave.
Gjatë periudhës nga dt. 01.01.2023, e deri më datë: 30.06.2023, janë pranuar gjithsej: 63,319 lëndë, prej të cilave 58,870 janë të kryera, 4,419 lëndë janë në proces, të pezulluara 30, respektivisht janë kryer 93% e lëndëve.
Bashkangjitur tabela me specifikacionet e trajtimit të lëndëve, sipas organeve përkatëse komunale:

**Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes**
**01/01/2023 - 30/06/2023**

| Shkurtesa | Pershkrimi | Pranuar | Ne Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshte | Pezulluar | Ceduar | Anuluar | Perfundu ar | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| DAP | Drejtoria e Administratës së Përgjithshme | 5 | 593 | 4,053 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 39,615 | 44,269 |
| DA | Drejtoria për Arsim | 12 | 548 | 528 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1,089 |
| DGJKP | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | 3 | 691 | 8,113 | 23 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 8,833 |
| DBF | Drejtoria e Buxhetit dhe Financave | 0 | 10 | 63 | 36 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 109 |
| DMSH | Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim | 0 | 34 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 34 |
| DUMM | Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit | 6 | 128 | 518 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 655 |
| DSHPIB | Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim | 1 | 114 | 1,108 | 1 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 1,227 |
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 1 | 722 | 1,754 | 146 | 1 | 2 | 0 | 2 | 0 | 2,628 |
| DBP | Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë | 0 | 384 | 549 | 161 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 1,096 |
| DZHE | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 0 | 8 | 9 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 20 |
| KK | Kuvendi i Komunës | 0 | 29 | 46 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 75 |
| KK | Kryetari i Komunës | 9 | 847 | 1,277 | 136 | 2 | 25 | 4 | 1 | 0 | 2,301 |
| DI | Drejtoria e Inspeksionit | 0 | 71 | 492 | 1 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 | 569 |
| DKRS | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 1 | 186 | 192 | 31 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 411 |
| | | 38 | 4,368 | 18,702 | 540 | 3 | 30 | 4 | 19 | 39,615 | 63,319 |

**Shërbimi i Autoparkut**

Autoparku funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe në kuadër të tij ka udhëheqësin dhe katër (4) vozitës.

Automjetet zyrtare të Komunës, janë duke u përdorur në përputhje me procedurat e parapara dhe në shërbim të kryerjes së detyrave zyrtare.

Këtë vit, nga janari, dy automjete Xhipa Toyota Prado fillimisht në shfrytëzim e pastaj në muajin mars, i janë dhënë donacion Policisë së Kosovës – Stacionit në Gjilan.

Të gjitha automjetet janë shfrytëzuar gjatë orarit të punës, nga ora: 08:00-16:00, me përjashtim të rasteve të kujdestarisë, rasteve emergjente, servisimeve të automjeteve dhe kur është pamundësuar arritja me kohë e zyrtarit për shkak se aktiviteti është kryer jashtë komunës. Edhe në rastet përjashtuese, gjithmonë është njoftuar paraprakisht përgjegjësi i Autoparkut.

Tanimë kemi vendosur edhe sistemin e navigimit, GPS, në të gjitha automjetet e administratës komunale përpos Skuterit.

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur aksidente me lëndime apo pasoja në njerëz.

Tabela në vijim pasqyron gjendjen e vitit 2022 dhe tani 2023.

| | **Km. e kaluara** | **Sasia e derivateve** | **%** |
|---|---|---|---|
| **2022** | 81829 | 7,076.25 | 8.54 |
| **2023** | 122635 | 10,606.12 | 8.54 |
| **Dallimi** | +40806 | +3,529.87 | |

**4. Shërbimi i TI-së**

Në Komunën e Gjilanit janë të angazhuar dy Zyrtarë të Teknologjisë Informative, me bazë në DAP, e që ofrojnë shërbime profesionale në të gjitha institucionet komunale përfshirë: Drejtoritë Komunale, shkollat, çerdhet, ambulancat, QKMF-të, etj.
Të gjitha shërbimet jepen në të gjitha institucionet komunale (drejtoritë komunale, shkollat fillore e të mesme, çerdhet, ambulancat, QKMF-të, etj.)

- Plotësimi i formularit 'Vlerësimi i kornizës së kontrollit të brendshëm'.
- Krijimi i formularit për kërkesat e QSHQ-së.
- Ndihmë DBF-së në krijimin e raportit për borxhet komunale.
- Ndihmë DBF-së në krijimin e raportit për tatimpaguesit – tatimi në pronë.
- Përgatitja e specifikimit teknik për tenderin për furnizimin me dy e-kiosqe të reja të gjendjes civile.
- Përgatitja e specifikimit teknik për tenderin për mirëmbajtjen e e-kiosqeve ekzistuese të gjendjes civile.
- Përgatitja e specifikimit teknik për tenderin për furnizim me kompjuterë dhe llaptop.
- Përgatitja e specifikimit teknik për tenderin për pajisje të ndryshme të TI-së.
- Përgatitja e specifikimit teknik për tenderin për furnizimin me TV për të gjitha AMF dhe QKMF.
- Përgjigje në kërkesat për sqarim nga OE lidhur me aktivitetet e lartshënuara të prokurimit.
- Përgatitja e specifikimit teknik për furnizime për Drejtorinë e Urbanizmit për nevojat e sistemit të adresave.

- Përgatitja e specifikimit teknik për furnizime për Bibliotekën e Qytetit me qëllim të funksionalizimit të rrjetit wireless në objektin e bibliotekës.
- Bartja e inventarit të sallës së trajnimeve nga zyrat e inkubatorit të biznesit tek depoja e komunës.
- Instalimi i Windows 10 në kompjuterët e vjetër që kanë qenë me Windows 7.
- Instalimi i Windows 11 në kompjuterët me Windows 10, instalimi i update-ve të reja. Kontakti me ASHI për ri funksionalizimin e Windows Update në PC-të në domain qeveritarë. Kontakti me ASHI për ri funksionalizimin e skanerëve për shkak të defektit në konfigurim në Domain Controller dhe Antivirus.

- Rregullimet e ndryshme të llogarive të email adresave në Active Directory (transfere, përshkrime, resetime të paswordëve, rritja e kuotës së e-mail adresave etj).
- Hapja dhe konfigurimi i email adresave për zyrtarët e ri komunal dhe zyrtarët me kontratë mbi veprën.
- Ri-funksionalizimi (formatizimi i të gjithë kompjuterëve, ndërrimi i baterive, kabllimet…) i kabinetit të informatikës të shkollës fillore "Nazmi Hoxha" si dhe shtrirja e rrjetit të internetit.
- Lëshim në punë të kompjuterëve të ri (formatim, konfigurim, instalim i printerëve dhe fotokopjuesve) si dhe bartja e të dhënave nga kompjuterët e vjetër në kompjuterët e ri.
- Asistim zyrtarëve gjatë ndërrimit të zyrës/sportelit (kabllimet, konfigurimet e printerëve-fotokopjeve etj.)
- Riinstalimi i softuerit të evidencave të vijueshmërisë në punë, konfigurimet dhe regjistrimi i kartelave/çelësave nëpër drejtoritë komunale. Ri funksionalizimi në raste të dëmtimeve fizike të kabllove.
- Krijimi i qasjes në rrjet për auditorët gjeneral.
- Ndihmë zyrtarëve gjatë shfrytëzimit të Excel dhe Word – formulat, tabelat, logot, fotografitë etj.
- Asistim zyrtarëve për kyçje në sistemin elektronik për deklarimin e pasurisë.
- Asistim zyrtarëve në kyçje në takime/trajnime online përmes platformave ZOOM/Skype etj.
- Asistim zyrtarëve në largimin e defekteve të ndryshme në printerët dhe fotokopjuesit (largimi i letrës së bllokuar/shqyer, ndërrimi i tonerëve dhe DRUM, konfigurimi i madhësisë së shtypit, pastrimi i waste etj.).
- Asistim teknikut të OE që bën mirëmbajtjen e printerëve dhe fotokopjuesve, si dhe kontakti i rregullt me qendrën e thirrjeve të OE për lajmërimin e defekteve në printerët dhe fotokopjuesit. Menaxhim i kontratës për shfrytëzimin e fotokopjuesve dhe printerëve.
- Asistim në mirëmbajtjen e ueb faqes zyrtare komunale (dhënie e instruksioneve dhe këshillave, përditësimi i linqeve, ngarkimi i raporteve dhe dokumenteve të ndryshme etj.).

- Asistimi në shfrytëzimin e sistemit të intranet-it si dhe hapja e llogarive të reja. Asistim në shfrytëzimin e versionit të ri të sistemit të intranetit si dhe rregullimi i roleve/qasjeve në sistem. Rregullimi i UNIREF-eve si dhe kodeve ekonomike për faturimet përmes Intranetit.
- Përkrahje teknike për transmetim live të mbledhjes së kuvendit.
- Riparimi i defekteve të natyrave të ndryshme (kabllot e ndryshme, kabllimet e rrjetit dhe telefonisë, telefonat lokal në centralet nëpër drejtoritë, instalime dhe konfigurime të driver-ëve dhe programeve të ndryshëm etj.), mirëmbajtja e rrjetit qeveritar si dhe linqeve mikrovalore.
- Kabllimet e reja të rrjetit tek kompjuterët ekzistues dhe printerët-fotokopjuesit.
- Kontaktet e rregullta me ASHI, Telkos dhe PTK mbi mirëmbajtjen dhe lidhjet e reja të rrjetit qeveritarë, internetit dhe telefonisë fikse.

**5. Të hyrat dhe shpenzimet**

Në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, funksionon Zyra e Financave, e cila kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë financiare sipas rregullave juridike të aplikueshme.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën raportuese është: 66,936.00 Euro.

Shpenzimet arrijnë lartësinë prej: 135,209.86 Euro gjithsej, respektivisht për mallra dhe shërbime: 125,116.69 Euro, për shpenzime komunale: 10,093.17 Euro.

**6. Aktivitete të tjera**

Së bashku me grupin punues, kryesuar nga Drejtoria e Administratës, kemi përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Raportin për zbatimin e këtyre rekomandimeve për pasqyrat financiare për vitin 2022.

Kemi dërguar kërkesën për inicimin e procedurës së prokurimit për mirëmbajte të E-Kioskave dhe blerjen e dy E-Kiosqeve të reja, me qëllim të ri funksionalizimit të tyre, por për shkak se nuk ka pasur asnjë ofertues për të di saten herë me radhë, procedura është anuluar.

Më datë: 23.02.2023, në seancën e Kuvendit Komunal të Gjilanit, me 30 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet propozim-vendimi i iniciuar nga ana ime dhe stafi i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, për faljen e gjobës komunale për regjistrimet e mëvonshme të lindjeve dhe vdekjeve.

Kemi hartuar draft-planin e integritetit 2022-2026, i cili ka kaluar procesin e konsultimeve publike dhe është në rend dite për miratim nga ana e Kuvendit Komunal të Gjilanit.

## 2. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Gjatë periudhës janar-qershor 2023, kemi filluar me zbatimin e planit të punës dhe me Aplikimin e plotë të legjislacionit në fuqi siç janë: Ligjet, Rregulloret, Udhëzimet Administrative dhe vendimet e ndryshme të miratuara në nivelin qendror dhe lokal të cilat kanë të bëjnë me sferën e shëndetësisë etj.

**I. Lidhur me Mbështetje financiare të OJQ-ve.**

- Kemi përgatitur dhe publikuar Vendimin për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare të OJQ-ve.
- Kemi përgatitur dhe publikuar Thirrjen Publike për mbështetje financiare të OJQ-ve.
- Kemi qenë pjesë e Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve në mbështetje financiare të OJQ-ve,
- Kemi përpiluar listën e OJQ-ve që kanë aplikuar për mbështetje financiare,
- Kemi përpiluar Rekomandimin për mbështetje financiare të OJQ-ve dhe ia kemi dërguar Kryetarit të Komunës për miratim,
- Kemi përpiluar Vendimet dhe Kontratat për mbështetje financiare të OJQ-ve,
- Kemi përpiluar procesverbalin mbi ecurinë e procesit,
- Pra, kemi zhvilluar të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me thirrjen publike për subvencionimin e OJQ-ve, për vitin 2023, bazuar në Rregulloren Nr. 04/2017 (MF).

**II. Lidhur me Rekrutimin e kandidatëve për vende të lira të punës në Mjekësinë Primare të QKMF-së.**

- Kemi përpiluar konkurse dhe ia kemi dërguar NJBNJ-së në Gjilan për publikim.
- Kemi përpiluar Listën e aplikantëve,
- Kemi qenë pjesë e Ekipit për verifikimin e aplikacioneve të kandidatëve,
- Kemi përpiluar Listën e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe e kemi dërguar për publikim në Web-faqen Zyrtare të Komunës.
- Kemi qenë pjesë e komisionit për vlerësimin e kandidatëve në testin me shkrim dhe intervistën me gojë,
- Kemi përpiluar Listën e kandidatëve me rezultatet e testit me shkrim dhe i kemi dërguar për publikim,
- Kemi përpiluar Listën e kandidatëve me rezultatet Definitive të testit me shkrim dhe intervistës gojë dhe i kemi dërguar për publikim,
- Kemi përpiluar Vendimet e kandidatëve me më së shumti pikë dhe i kemi dërguar për publikim,
- Kemi përpiluar Procesverbalin mbi ecurinë e procesit të rekrutimit nga publikimi i konkursit e deri tek publikimi i rezultateve përfundimtare,
- Pra, kemi zhvilluar të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë lidhur me procedurat e rekrutimit.

## III. Kemi zhvilluar edhe aktivitete të tjera duke përfshirë:

- Përpilimin e vendimeve të ndryshme për nevoja të DSHMS-së dhe shërbimeve të tjera në kuadër të QKMF-së dhe Komunës,
- Vendime për formimin e komisioneve të ndryshme,
- Përgjigje ndaj shkresave të ndryshme të dërguara nga Institucionet komunale, të OJQ-ve të ndryshme dhe të palëve,
- Konsultime me palë për çështje të ndryshme,
- Kemi ofruar edhe ndihmën profesionale për nevojat e shërbimeve të DSHMS-së.

## IV. Kemi pasur bashkëpunime me:

- QKMF-në, NJBNJ, Zyrën e Kryetarit të Komunës-Koordinatoren për Shëndetësi, OJQ-të, QSHQ, QPS-në etj.

## V. Kemi përpiluar Njoftime për palët që kanë bërë kërkesa për subvencionim për barëra:

| | **Aprovime** | **Refuzime** | **Totali** |
|---|---|---|---|
| **Kërkesa** | **430** | **125** | **555** |

Gjatë këtij gjashtëmujori të punës janar-qershor 2023 si zakonisht kemi pasur dhe kemi kërkesa të ndryshme të qytetarëve të natyrës shëndetësore: për barëra (ndihmë financiare për mjekim, për syza mjekësore - me dioptri), kërkesa për lehona, kërkesa nga aspekti social, për strehim etj.

Kërkesa për barëra (mjekim) në këtë gjashtëmujor janë shqyrtuar 617, prej tyre 445 aprovime dhe 172 refuzime dhe 73 kërkesa të muajit qershor janë në proces, ku pas shqyrtimit nga komisioni, mbyllen në sistemin e databazës.

Kërkesa për barëra (mjekim) për këtë gjashtëmujor, gjithsej janë: 690 kërkesa.
Kërkesa për strehim: 55 aprovime, 31 refuzime, 3 kërkesa në proces, gjithsej 89 kërkesa.
Aplikacione për lehona janë 75 (në proces), aplikacione për punësim nga OJQ-të janë 24 (në proces).

Aplikacione të konkursit të fundit, për mjekë, infermier (të muajin mars) gjithsej janë 388, ku pas kryerjes së procedurave të ankimimit që mund të zgjasë rreth 20 ditë (njoftuar nga zyrtari ligjor në DSHMS), mbyllen një nga një në sistemin e data bazës.

Kërkesa të hyra në drejtori në këtë gjashtëmujorë për barëra dhe strehim gjithsej janë: 779
dhe aplikacione për konkurs, për lehona dhe të OJQ-ve gjithsej janë: 487

Vendime, njoftime, kërkesa shkresa etj. të protokolluara nga Drejtoria për Shëndetësi nga sistemi i protokollit unik janë 74.

Të gjitha këto materiale: Vendime, Kërkesa të ndryshme dhe materiale tjera arkivohen në hapësirat e DSHMS-së

## QENDRA PËR PUNË SOCIALE

| Nr. | **Kategoria e shfrytëzimit** | **Nr. i rast.** | | **Llojet e intervenimit** | **Rezultatet e arritura** | **Vërejtje** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Shërbimet Rezidenciale** | **Të vjetra** | **Të reja** | | | |
| 1.1. | Kujdestaria për rastet e veçanta. | | | Me kërkesë të Gjykatës, caktohet kujdestari i përkohshëm për prezantim në seancë gjyqësore. | I merret zotësia e veprimit plotësisht | Caktimi i kujdestarisë së përhershme varësisht vendimit të gjykatës dhe rekomandimeve. |
| 1.2 | Strehimi në shtëpi me bazë në komunitet. | | | Pranimi i kërkesës, caktimi i menaxherit të rastit, vlerësimit profesional | Vlerësimi profesionale, referimi ne Organet Kompetente DPSF | |
| 1.3 | Strehimi i viktimave të dhunës në familje. | | | Vlerësimit profesional. bashkëpunimi me Policinë njësiti kundër dhunës, Prokurorinë, Gjykatat | Vlerësimi për vendosjen në strehimore | Bashkëpunimi me MV, Policinë Prokurorinë dhe Gjykatën |
| 1.4 | Strehimi i viktimave të trafikimit. | 1 | | Vlerësimi profesional, bashkëpunimi me policinë, prokurorinë, MV, Strehimoret | Re integrim ne familje biologjike | Strehimoren shtetërore në Lipjan |
| 1.5 | Kërkesë për vendosje në institucione të mbrojtjes sociale Shtëpi të Pleqve Prishtinë | 1 | | Kërkesa te reja, vizitë shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar, vlerësimi i kërkesës, | Përcjellja e gjendjes se te moshuarve përmes vizitave dhe konsultimeve, | 2 raste në procedurë nga se njëri ka dal pozitiv me HEPATIT C ,nuk vendoset deri sa te evitohet infeksioni |
| 1.6 | Të trajtuarit e shëndetit mendor të kateg.të ndry. | | | Sesionet këshilluese individuale, familjare, | Pas vlerësimit të nevojës-referim i rastit ne institucionet | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bashkëpunim me institucionet e nevojshme në rast | përkatëse QSHM, Psikiatri etj | |
| **2.** | **Shërbimet familjare** | | | | | |
| 2.1 | Fëmijët e braktisur të porsalindur (pa përkujdesje) | 2 | | Vizitë përcjellëse e rasteve të vjetra të vendosura në strehim familjarë, sesion këshillues individual familjarë. | Fëmijët në gjendje të mirë shëndetësore, kompensimi material nga MPMS me rregull. | |
| 2.2 | Fëmijët me sjellje asociale | 12 | | Vizitë shtëpiake, sesione këshilluese individuale familjare-raste te reja | Janë udhëzuar të] ushtrojnë mbikëqyrjen prindërore ndaj fëmijës se tyre. | Bashkëpunim me Policinë, Shkollat, OJQ etj. |
| 2.3 | -Abuzimi i fëmijëve jashtë familjes, Abuzim seksual, fizik etj | 5 | | Sesione këshilluese individuale ,familjare, specialistet e fushës shëndetësore dhe psikologjike | Referime për trajtime psikologjike-psikiatrike apo gjinekologjike | Bashkëpunim me institucionet e nevojshme ne raste, |
| 2.4 | Kujdestaria për të mitur | | | | | |
| 2.5 | Kujdestaria për të rritur. | 2 | | Vizitë përcjellëse, sesione këshilluese individuale familjare, | Sesione këshilluese individuale, familjar, përgatitja e raporteve, pjesëmarrje në seancat gjyqësore, dhënia e mendimit profesional . | Nxjerrja e Aktvendimit për Kujdestari të përkohshme apo të përhershme, varësisht rekomandimeve nga Gjykata. |
| 2.6 | Bashkimi familjar | | | | | |
| 2.7 | Kërkesa për Birësimi me element vendor | 2 | | Caktimi i menaxherit të rastit, krijimi ekipin profesionalë zhvillimi i procedurës së vlerësimit. Kërkesë e re në procedurë të vlerësimit adoptim vendor, | Vlerësim pozitiv-negativ. Bashkëpunimi me DPSF-Gjykatën | Bashkëpunime me gjykatën, DPSF, Panelin,etj Përcjellje e rastit deri në zgjidhjen definitive |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.8 | Birësimi me element ndërkombëtar. | | | | | |
| 2.9 | Strehimi në familjet farefisnore. | 4 | | Vizitë përcjellëse rasteve të vjetra në strehim, | Vizitë përcjellëse rasteve, sesione këshilluese individuale, familjare, konsultime për rastet | Përpilimi i aktvendimeve, kontratës në bashkëpunim me DPSF |
| 2.10 | Fëmijët nën Kujdestari | 5 | | Vizita familjare, sesione këshilluese individuale, familjare, konsultime për rastet | Vlerësimi i kërkesës-caktimi i kujdestarit te përkohshëm-fëmijë jetim. | Përpilimi i aktvendimeve për kujdestari, futja ne bazën e te dhënave, bashkëpunim me DPSF |
| 2.11 | Strehimi në familjet alternative. | | | Vizita familjare, sesione këshilluese individuale ,familjare, konsultime për rastet, | Vlerësimi i kërkesës-caktimi i kujdestarit | Përpilimi i aktvendimeve, kontratës bashkëpunim me DPSF |
| 2.12 | Shërbime për reintegrimin e viktimave të trafikimit. | 1 | | Sesione këshilluese individuale, familjare, mendime profesionale, strehimi | Reintegrim në familje, shkollë, sistemin e punës | Bashkëpunim me institucionet e Drejtësisë dhe mbrojtjes sociale |
| 2.13 | Shërbime për viktima të dhunës në familje. | 91 | | Vizitë shtëpiake, sesion këshillues individualë, familjar, ndihmë e përgjithshme për klientin, | Vazhdim i bashkëpunimit dhe kontakteve lidhur me rastin. | Përcjellja e rastit , bashkëpunime me Gjykatën, strehimoret, policinë, prokurorinë, MV. |
| 2.14 | Ndihmë në rregullimi e marrëdhënieve bashkëshortore. | 11 | | Vizite shtëpiake-sesione këshilluese individuale,familjare,konsultime për rastin-rast ne procedure te vlerësimit | Vazhdimi i bashkëpunimit-procedure te shkurorëzimit-ndarjes. | Përcjellje e rasteve, mbajtja e kontakteve, bashkëpunim me Gjykatën. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.15 | Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve. | 21 | | Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual,familjar,dhënia e mendimit për besimin e fëmijës dhe lejimin e kontaktit prind fëmijë. | Vlerësimi profesional ,përgatitja e mendim propozimit për besimin e fëmijëve për lejimin e kontakteve rekomanduar Gjykatës. | Përcjellja e rastit, realizimi i kontakteve sipas Aktvendimit. |
| 2.16 | Dhënia e mendimit për martesa të të miturve. | 1 | | | | |
| 2.17 | Persona me nevoja të veçanta. | | | | | |
| 2.18 | Ndihmë në realizimin e kontakteve prind-fëmijë. | | | Pranimi i kërkesave, caktimi i menaxherit të rastit ,vlerësimi i nevojave | Varësisht rrethanave, | Raste të vjetra nga muajt paraprak |
| 2.19 | Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer. | 1 | | | | |
| 2.20 | Fëmijët me aftësi të kufizuara. | 31 | | Pranimi, paraditja e dosjes për K. Mjekësor. Organizimi i KM, ftesat e palëve, prezantimi lëndëve në Komision Mjekësor, futja në bazën e të dhënave, nxjerrja e aktvendimeve, Menaxhimi i lëndës. | Monitorimi i lendes sipas ligjit ne fuqi | KM ka aprovua 12 kërkesa pozitive,6 në plotësime,1 negativ |
| **3** | **Shërbimet e komunitetit** | | | | | |
| 3.1 | Fëmijët në punë | | | Vizitë shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar. | Sesione këshilluese individuale,familjare,në procedurë të tërheqjes së fëmijëve nga punët e rrezikshme, | |
| **4.** | **Bashkëpunim me institucionet Publike.** | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1 | Shërbime për fëmijë në konflikt me Ligjin. | 30 | | Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual, familjarë | Sesion këshillues individual, familjar ,udhëzime për mos kryerjen e veprave dhe mbikëqyrjes prindërore, dërgimi i raportit social gjykatës | Raport për Gjykatë-Kundërvajtje, si dhe Masa Organit të Kujdestarisë.. |
| 4.2 | Prezantim në seanca Gjyqësore-Prokurori | 75 | | Prezantim në seancë gjyqësore, për të mitur, dhune në familje si dhe adoptime. | | |
| 4.3 | Prezantim në Polici. | 30 | | Pjesëmarrje në seance-intervistim në polici, të mitur, | Pas intervistimit te gjithë te miturit lirohen | |
| **5.** | **Shërbimet Tjera** | | | | | |
| 5.1. | Konsultim me palë | 2146 | | .Konsultime te ndryshme lidhur me rastet ne QPS, rastet e reja dhe atyre nen përcjellje-monitorim. | | |
| 5.2. | Vizita- familje, spital, QSHM, OJQ-ët etj | 226 | | Vizitat shtëpiake, në institucione për rastet e reja, të vjetra dhe me kolege. | | |
| 5.3 | Vizita institucionale | 9 | | Shtëpi te Pleqve Prishtine, SHI Kamenice ,Strehimore Liria ne Gjilan, etj. | | |
| **6.** | **Shërbimet Administrative** | | | | | |
| 6.1 | **Klient tjerë**: vërtetimet konstatimet zyrtare etj: | 279 | | Klient tjerë, vërtetime, konstatime zyrtare etj. | | |
| 6.2 | Shkollat-DKA | 9 | | Raste te referimit-bashkëpunimit me shkollat. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.3 | Futja e rasteve në bazën e të dhënave | 1410 | | Futja e rasteve te reja në bazën e të dhënave dhe shërbimeve e intervenimeve në rastet e vjetra. | | |
| 6.4 | DPSF-Prishtine | 98 | | Njoftime, referim, bashkëpunim | | |
| 6.5 | Bashkëpunim me QSHM-QKMF | 7 | | Referim te rasteve me çrregullime me ndore për trajtim. | | |
| 6.6 | Bashkëpunim me Familjet strehuese | 21 | | Bashkëpunim me familjet strehuese, konsultim për gjendjen e fëmijëve, pagesat etj. | | |
| 6.7 | Bashkëpunim me Strehimoren "Liria"- | 6 | | Bashkëpunime | | |
| 6.8 | Bashkëpunim me QPS | 64 | | Kontaktime për çështjet e adoptimit fëmijë-familje.. | | |
| 6.9 | MVPT-Prishtinë | | | Konsultime lidhur me rastin social | | |
| 6.10 | SOS Fshati Prishtinë | 13 | | Vizitë bashpunuese me SOS Fshatin e Fëmijët Prishtinë lidhur me dy fëmijët e vendosur . | | |
| 6.11 | Takime Ekipi vlerësues DKA | - | - | Takime vlerësuese neper shkolla-Seminar | | Ne këtë ekip nga Drejtoresha DSHMS është caktuar anëtarë e ekipit shefica e ASS |
| 6.12 | Trajnim | 1 | | 1.Baza Komunale e të dhënave për rastet e ndjeshme | | |
| 6.13 | HHCH-Prishtinë | | | Bashkpunime.3 fëmijë të strehuar dhe është bërë bashkimi familjar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.14 | Komision mjekësor | 2 | | Kërkesa te shqyrtuara FFAK fëmijë, pranimi kërkesave, përgatitja e konkluzave ,organizimi i KM, prezantimi i lendeve, informimi i palëve, futja e rasteve në bazën e të dhënave. | Monitorimi deri ne mbushjen e moshës, përkatësisht ndërrimit të vendbanimit apo tjetër | 19 raste, 12 pozitiv, 1negativ 5 plotesim, 1 mungon |
| 6.15 | Seminar-punëtori | 2 | | Mekanizmi koordinues Komunikim me publikun Baza e të dhënave VDH | | |
| 6.16 | TMR | | | Organizimi dhe mbajtja e TMR-shqyrtimi i 1 rasti | U realizua vlerësimi, plani i veprimit | Morën pjesë Policia Nj. Anti trafikim, Kundër dhunës në familje, DKS, MV, Psikologu |
| 6.17 | Bashkëpunim me Gjykatën dhe Prokurorinë | 40 | | Shkresa gjykatës për rastet pa adrese, konstatime zyrtare etj | | |
| 6.18 | Bashkëpunim me SHI Kamenice | 5 | | | | |
| 6.19 | Bashkëpunim me strehimoren shtetërore ne Lipjan | 2 | - | Vizita, sesione këshilluese | | |

## Qendra për Punë Sociale

| | Aktivitetet | Kategoria 0 | Kategoria 1 | Kategoria 2 | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| APLIKIMI | 1. Nr. i rast. që kanë aplik. për herë të parë. | 1.1+1.2+1.3 | 1.1+1.2+1.3 | 1.1+1.2+1.3 | 1.1+1.2+1.3 | Kategoria 0+1+2 |
| | | | 29 | 11 | 40 | |
| | Sa prej tyre janë të aprovuara | | 18 | 6 | 24 | |
| | Sa janë në shqyrtim | | 3 | 2 | 5 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sa prej tyre janë të refuzuara | | 8 | 3 | 11 | |
| RIAPLIKIMI | 2. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim | | | | | Kkat. 0+1+2 |
| | 3. Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar | | 305 | 63 | 368 | |
| | 4. Numri i rast. të larguar për mungesë të dokumentacionit | | 51 | 6 | 57 | |
| VERIFIKIMI | 5.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara | 1+2+3+4 | 1+2+3+4 | 1+2+3+4 | 1+2+3+4 | Kat. 0+1+2 |
| | | | 334 | 89 | 423 | |
| | 5.1. Sa prej tyre janë aprovuar | | 263 | 76 | 339 | |
| | | | | | | |
| | 5.2.Sa janë refuzuar/çregjistruar | | 70 | 13 | 83 | |
| | | | | | | |
| | 5.3. Sa janë në procedurë e sipër | | 1 | / | / | |
| | | | | | | |
| KOM. MJEKËSOR | 6. Nr i rasteve të dërgua. në Komi. Mjek.(KM) | 6.1+6.2+6.3 | 6.145v v +6.2+6.3 | 6.1+6.2+6.3 | 6.1+6.2+6.3 | Kat. 0+1+2 |
| | | | 361 | / | 361 | |
| | 6.1. Numri i rasteve të aprovuara nga KM | | 297 | / | 297 | |
| | 6.2. Numri i rasteve të refuzuara nga KM | | 64 | / | 64 | |
| | 6.3. Numri i rasteve të kthyera nga KM për kompletim dokumentacioni | | / | / | / | Kat. 0+1+2 |
| | | | | | | |
| | | A+B+C | | A+B+C | A+B+C | K |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 7. Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit | | 78 | / | 78 | |
| | A. Në shkallë të parë( I ) | a1+a2+a3 | | a1+a2+a3 | a1+a2+a3 | |
| | | | 38 | / | 38 | |
| | a) 1. Ankesa të pranuara | | 17 | / | 17 | |
| | a) 2. Ankesa të refuzuara | | 5 | / | 5 | |
| | a) 3. Ankesa në procedurë e sipër | | 16 | / | 16 | |
| | B. Në shkallë të dytë(II ) | b1+b2+b3 | | b1+b2+b3 | b1+b2+b3 | |
| | | | 35 | / | 35 | |
| | b) 1. Ankesa të pranuara | | 1 | / | 1 | |
| | b) 2. Ankesa të refuzuara | | 25 | / | 25 | |
| | b) 3. Ankesa në procedurë e sip. | | 9 | / | 9 | |
| | C. Kontestet në Gjykata | C1+c2+c3 | C1+c2+c3 | C1+c2+c3 | C1+c2+c3 | |
| | | | 5 | / | 5 | |
| | c) 1. Kontestet të pranuara | | / | / | / | K 0+1+2 |
| | c) 2. Konteste të refuzuara | | / | / | / | |
| | c) 3. Konteste në procedurë e sip. | | 5 | / | 5 | |

- 0 - vërtetim se janë shfrytëzues të ndihmës sociale,
- 105 - vërtetime se nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale.
- 14 - vërtetime për lirim të shtetësisë
- 119 - Gjithsej vërtetime

**RAPORTI PËR PUNËN E KOMISIONIT PËR NDIHMA SOCIALE NË REGJIONIN E GJILANIT**

Është mbajtur komisioni mjekësor për muajin Janar- Qershor ku kanë qenë gjithsej **361** lëndë, prej tyre janë aprovuar **297** lëndët dhe janë refuzuar **64** lëndë, në mungesë të raporteve të bollshme mjekësore nuk kemi pasur.
Gjatë këtyre muajve kemi bërë shpërndarjen e 400 pakove ushqimore për shfrytëzuesit e ndihmave sociale nga organizata Qatar Charity. Gjithashtu kemi pas edhe donacione tjera nga Organizata Islamik Reliefi, dhe disa bashkatdhetarë ku kemi bërë shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për 130 familje.
Drejtori i QPS së bashku me një donator-bashkatdhetar ka bërë shpërndarjen e disa mjeteve në vlerë 3000 euro për 5 familjeve në nevojë. Gjithashtu në prag të festës së Kurban Bajramit, Komuna në bashkëpunim me DSHM-sën dhe QPS kanë bërë shpërndarjen 250 pako ushqimore për familjet në nevojë ku kanë qenë të përfshirë edhe rastet me asistencë sociale të cilët janë edhe shfrytëzues të banimit social.

## 3. DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës gjashtëmujore janar-qershor 2023, ka arritur me sukses t'i realizojë objektivat e planifikuara të cilat kanë qenë të bazuara në planin e punës, si dhe angazhime të shtuara në përmbushjen e kërkesave dhe obligimeve të paparashikuara. për periudhën kohore janar-qershor për vitin shkollor 2022/23.

- **Aktivitetet e zbatuara për periudhën raportuese gjashte mujore janar –qershor 2023.**

Duke marrë parasysh trendët e mbështetjes në politikat e zhvillimit të sistemit arsimor në Komunën tonë, deri më tani janë ndërmarrë hapa konkretë sipas planit të punës të DKA-së për të fuqizuar trajtimin e të gjitha niveleve të arsimit para universitar, ku gjendja pritet të ndryshojë konsiderueshëm përmes realizimit të aktiviteteve të zbatuara.

- **Aktivitetet e realizuara në fushën e infrastrukturës:**

Angazhime në krijimin e hapësirave fizike për përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve në nivelin e arsimit parashkollor, përmes ndërtimit të objekteve të reja të destinuara për qëndrim ditor;

- Inaugurimi i çerdhes në Zhegër,
- Aktualisht në komunën e Gjilanit në ndërtim e sipër janë tri institucione parashkollore me qëndrim ditor, dy në zonën urbane dhe një në zonën rurale : IP në lagjen "Qarku 1", me kapacitet për gjithsej njëqind e njëzet (120) fëmijë të moshës 9 muaj deri ne 5 vjeç.
- IP në lagjen Arbëria dhe në fshatin Miresh. Drejtoria e Arsimit është në komunikim të vazhdueshëm me divizionin e Infrastrukturës në kuadër të MASHTI-t për dinamikën e punimeve në këto tri IP.

- Bazuar në planifikimin e Qeverisë së Kosovës, miratuar në Kuvendin e RK, për ndërtimin e çerdhes së re në fshatin Miresh, kemi realizuar një analizë të gjendjes së numrit të fëmijëve nga moshat 0-6 vjeçe, dhe jemi në proces të grumbullimit të të dhënave plotësuese të këtij projekti.
- DKA është në fazën e analizave për mundësinë e ndërtimit të çerdheve modulare lëvizëse për dy zona rurale.
- Renovim të kulmit në Integj dhe tek Ardhmëria I, duke vazhduar në muajin korrik edhe me renovim te tërësishëm të çerdhes "Integj",
- Pajisje me dollap individual për të gjithë nxënësit e shkollave fillore të nivelit I-IV, në vlerë prej 170.000 euro.
- Pajisje me rripa të sigurisë për të gjithë nxënësit e klasës së parë,
- Hapja e qendrës së karrierës,
- Hapja e kabinetit të mini-cnc në Selami Hallaçi,
- Hapja e kabinetit të Auto-Cad,-it në Shmt "Mehmet Isai",
- Pajisje me makina të pastrimit për dy shkolla fillore mbështetur nga Mashti,
- Pajisje me dy laboratorë të shkencave natyrore në shkollën "Musa Zajmi" & "Nazmi Hoxha",
- Hapja e bunarit tek shkolla e muzikës dhe mbjellja e fidanëve në oborrin e shkollës nga projekti Yeni,
- Vendosja e paneleve solare tek shkolla profesionale ekonomike "Marin Barleti",
- DKA ka deponuar dosjen dhe kërkesën për ndërtimin e çerdhes në lagjen 'Livadhet e Arapit', nga divizioni i infrastrukturës MASHTI, kemi marrë konfirmimin pozitiv për fillimin e ndërtimit të çerdhes së ne vitin 2024.
- Për krijimin e kushteve më të mira të ambienteve të klasave përgatitore, gjatë muajit maj 2023, DKA në bashkëfinancim me Caritasin Zviceran. kanë furnizuar me inventar dhe pako didaktike, pesë klasa para fillore, në kuadër të SHFMU-ve.
- Pas pranimit të kërkesave për renovime, kemi bërë planin dinamik për realizimin e tyre sipas kërkesave dhe buxhetit të planifikuar për investime.
- Është dorëzuar kërkesa për adaptim të objektit të postës në objekt të Çerdhes në fshatin Bresalc tek Shërbimet me Qytetarë për në drejtorinë e Urbanizmit, më datën- 08.06.2023
- Përgatitja e kërkesës për bartjen e pronësisë në Kadastër, për adaptim të Çerdhes në objektin e Ambulantes, në fshatin Livoç i Epërm.
- Marrja e aktvendimit nga drejtoria e Kadastrit për parcelën në Livoç të Epërm.
- Marrja e përgjegjës nga drejtoria e Urbanizmit për parcelën e Postës në fshatin Bresalc.
- Marrja e leje pëlqimit nga ana e drejtorisë së Urbanizmit për shfrytëzimin e objektit të Ambulantes,

**Aktivitetet e realizuara në fushën e Arsimit**

- **Konkurset për regjistrimin e fëmijëve dhe nxënësve në IEA**

- Publikimi i Konkursit për regjistrimin e fëmijëve në nivelin e arsimit para fillor mosha 5-6 vjet, në kuadër të shkollave fillore të mesme të ulëta në komunën e Gjilanit për vitin shkollor 2023/2024.
- Publikimi i konkursit, për përfshirjen e fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike në Komunën e Gjilanit.
- Publikimi i konkursit, për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë,
- Planifikimet për testin e maturës,
- Inicimet për projekte kapitale të gjitha të përfunduara me kohë,
- Planifikimi dhe inicimi i ditarëve shkollor,
- Planifikimi i librave shkollore,

**Angazhimet profesionale në zbatim të aktiviteteve gjithëpërfshirëse në ngritjen e cilësisë për nivelin e arsimit para universitar**

- Gjatë muajve janar-mars, janë realizuar 20 punëtori në ambientet e DKA, për hartimin e PZHKA 2023/2026, si dhe një sërë takimesh dhe punë në nëngrupet sipas niveleve të arsimit
- Në kuadër të vizitave në IEA, Drejtoresha e DKA-së e shoqëruar me zyrtarët, për periudhën kohore janar-qershor 2023, ka realizuar vizita në gjitha shkollat e komunës, sipas planit dinamik të aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të pa parashikuara.
- Gjatë muajit prill- maj 2023, janë realizuar gjithsej: njëzetë e dy (22) vizita monitoruese si dhe të paparashikuara në nivelin e arsimit para fillor në kuadër të institucioneve parashkollore dhe klasave përgatitore në kuadër të shkollave.
- Janë realizuar vizita monitoruese të vazhdueshme në institucionet e arsimit para universitar.
- Angazhime permanente në komunikim të përditësuar individual dhe grupor me IEA-të për menaxhimin e gjendjes në arsim, në të gjitha nivelet, (riorganizimet e brendshme në shkolla, përcjellja e vijueshmërisë së fëmijëve/nxënësve, higjiena dhe dezinfektimi i shtuar. Është realizuar delegimi i zëvendësimeve, sipas kërkesave të IEA-ve
- Në bazë të detyrave dhe përgjegjësive, DKA ka iniciuar themelimin e Këshillit të Prindërve në nivel komune. Në kuadër të fuqizimit të rolit të këshillave drejtuese të IEA-ve. Nga MASHTI është kërkuar që DKA të bëjë plotësimin e këshillave drejtuese të shkollave dhe organeve drejtuese të shkollave si dhe monitorimi i punës së këshillave drejtuese të IEA-ve sipas Udhëzimit Administrativ 2023 përmes procesverbaleve.
- Takime të rregullta javore me udhëheqësit e IEA-ve, rreth identifikimit dhe mbështetjes së nevojave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të punës edukativo-arsimore në të gjitha nivelet e arsimit pan universitar.

- Takime të rregullta pune në baza ditore dhe javore me zyrtarët e DKA-së,
- Takime individuale me palë të interesit
- Takime me organizata vendore dhe ndërkombëtare
- Mbajtja e sesioneve informuese se bashku me ekipin vlerësues pedagogjik në kuadër të shënimit të 21 marsit dhe 2 prillit, janë realizuar sesione informuese në disa SHFMU të komunës sonë, me mësimdhënësit lidhur me sfidat, rolin dhe rëndësinë e ekipit vlerësues, planin individual, si dhe rëndësinë e intervenimit të hershëm tek nxënësit.
- Gjate periudhës janar- qershor, ekipi vlerësues ka bërë vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, duke i sistemuar nëpër shkollat e komunës sonë, ofrimin e këshillimit, të prindërve në situata të ndryshme, qasje dhe mbështetje profesionale si dhe referimin e rasteve për marrjen e shërbimeve të ndryshme.
- Planifikimi dhe përgatitjet për testin e arritshmërisë dhe maturës shtetërore (caktimi i qendrave të testimit, administruesve, vëzhguesve dhe numri i nxënësve pjesëmarrës).
- Është bërë përgatitja dhe realizimi i testeve ndërkombëtare: PISA, TIMSS dhe ICIRLS.
- Organizimi dhe mbështetja e garave shkollore në nivel të Komunës dhe Republikës, si: Olimpiada matematikore e Gjilanit 2023, Garat e Fizikës, Garat KANGAROO etj.
- Për herë të parë bëhet implementimi i programit “Arti në Shkolla”, si komunë e parë përzgjedhëse jemi ne për të edukuar tutje fëmijët në fushën e artit,
- Promovimi i profileve profesionale tek prindërit dhe nxënësit e shkollave fillore,
- Vizita dhe mbajtja e praktikes në shkolla profesionale nga nxënësit e shkollave fillore klasat e IX-ta,

**Planifikimi dhe plotësimi i normave mësimore**

- Kemi iniciuar grumbullimin e të dhënave për fondin e orëve të mësimdhënësve në të gjitha nivelet e arsimit në komunë, i cili është njëri nga objektivat e DKA-së, sipas planit të veprimit, si dhe strategjisë së udhëheqjes për vitet në vazhdim.
- Sipas ligjeve në fuqi, ne kemi ndjekur të gjithë hapat ligjorë, dhe deri në qershor kemi përgatitur konkursin për vendet e lira në arsim, gjithnjë duke e pasur parasysh edhe stabilizimin e normave të mësimdhënësve të rregullt.
- Janë mbajtur takime me të gjithë drejtorët e shkollave Fillore te Mesme të Ulëta rreth harmonizimit dhe planifikimit të normave mësimore,
- Kemi mbajtur takime të ndara veç e veç me të gjithë drejtorët e shkollave të Mesme të Larta rreth planifikimeve të paraleleve dhe normave në gjitha shkollat e ML.

- Pas analizave tona, në kemi shpallur konkursin e rregullt për vendet e lira dhe ato me afat të caktuar, sipas afateve të parapara, dhe për vitin e ri shkollor 2023/2024, jemi të gatshëm të fillojmë të përgatisim kuadro si duhet.
- Konkursi për tetë pozita për psikologë, është në proces të realizimit të procedurave.

**Trajnimet dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe personelit në IEA**

- Punëtori me kryetarët e aktiveve profesionale të edukatoreve në kuadër të shkollave dhe institucioneve parashkollore
- Pjesëmarrje e vazhdueshme e mësimdhënësve në trajnime të licencuara nga MASHTI, në të gjitha nivelet e arsimit para universitar,
- Grumbullimi i nevojave për zhvillim profesional dhe trajnime për personelin arsimor në bashkëpunim me MASHTI-in.
- Organizimi i punëtorive me nxënës të shkollave të mesme.

**Pjesëmarrja e zyrtarëve  në punëtori dhe forume**

- Pjesëmarrje në dy punëtori të ndara  dy ditore me zyrtarët e nivelit të arsimit parashkollor të DKA-ve në nivel të  Republikës, në kuadër të projektit SHPRESË  të organizuar nga Caritasi Zviceran në Kosovë.
- Pjesëmarrje në punëtori të organizuar nga rrjeti ballkanik i gazetarisë hulumtuese me temë "procesi i ri-integrimit dhe ri-socializmit të personave që kanë rënë ndesh me idetë radikale".
- Pjesëmarrja në takim me forumin e aftësisë së kufizuar dhe institucionet komunale, tema: të arriturat, sfidat dhe përgjegjësitë ndaj FNV.
- Punëtori  kreative me prindërit fëmijët dhe edukatoret në dy institucione parashkollore, mbështetur nga Save the Children dhe DKA,

**Organizimi dhe realizimi i eventeve për nderë të shënimit të datave të rëndësishme**

- Organizimi, menaxhimi, monitorimi dhe shënimi i "7 Marsi – Dita e Mësuesit".
- Organizimi dhe shënimi i ditës ndërkombëtare të Sindrome Down, 21 mars.
- Pjesëmarrje në organizime – evente të ndryshme të shkollave.
- Organizimi i eventit "1 Qershori Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve ", me pjesëmarrës aktiv të një numri të fëmijëve të moshës 5-6 vjeçare në Kampusin e shkollave të mesme.

- Shënimi i ditës së mjedisit, 5 Qershori, me aktivitete të ndryshime si; mbjellja e fidanëve me nxënësit, kampanjë vetëdijesimi për eliminimin e plastikes si përdorim dhe ruajtjen e ambientit.

**Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të palëve në sektorin e arsimit;**

- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave me shkrim të palëve, edukatoreve, mësimdhënësve, prindërve, studentëve për vijimin e praktikës nga kolegjet private, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, drejtorive të linjës në kuadër të komunës dhe mediave.
- Në kuadër të DKA-së është themeluar komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave nga Marrëdhënia Juridike e Punës.
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për periudhën e raportimit ka shqyrtuar ankesat të cilat u janë adresuar si komision në kuadër të DKA-së.

**Raporti i zyrës së financave, Janar-Qershor 2023**

- Financa, furnizim, kontabilitet dhe infrastrukturë.
- Përgatitje e planifikimit te buxhetit për vitin 2024
- Konsultimi me drejtorët e shkollave , IP rreth planifikimi të buxhetit 2024 dhe përgatitja e raporteve për ato kërkesa.
- Analizimi i kërkesave të shkollave , IP për investime , shpenzime për vitin aktual 2023 dhe 2024 dhe menaxhimi i tyre.
- Përgatitja e raporteve të hyrave nga shkollat dhe IP, konvikti , kërkesat për raporte mujore.
- Konsultime me kompanit kontraktore rreth obigimeve, dhe pagesa e tyre.
- Analizimi i buxhetit aktual 2023, dhe menaxhimi i tij në planifikimet deri në fund vit,
- Përgatitja e nën alokimeve për TM 2.
- Konsultimi me drejtorët të shkollave, IP për buxhetin dhe menaxhimin e tij deri në fund vit.
- Pranimi i kkërkesave të ndryshme nga shkollat .
- Regjistrimi i rasteve të ddërguara për zotim, kontrollimi në bazë të rrjedhës së parasë.
- Aktivitete eventuale tjera të cilat paraqiten sipas kohës dhe nevojave në DKA si dhe nga institucionet.
- Pagesa e rrymes dhe obligimeve tjera komunale për të gjitha shkollat në vlerë prej 24,691.64 Euro.
- Takim me koordinatorit e KEK-ut Bekim Xhakaj rreth çeshtjeve të borgjeve të shkollave.
- Menaxhimi i buxhetit të shkollave.
- Verifikimi i faturave dhe komonikimi me furnizues rreth faturave.
  Përgatitja e lëndëve për pagesë për DKA dhe shkollat serbe
- Bashkëpunimi me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa lidhur me ekzekutimin e lëndëve për pagesë.

- Bashkëpunimi me Zyrën e Prokurimit lidhur me inicimin e aktiviteteve të prokurimit.
- Mbajtja e kontabilitetit
- Regjistrimi i lëndëve (522 lëndë) për vitin 2023
- Mbajtja e programit e-financa për DKA dhe IEA-të.
- Protokollimi dhe regjistrimi faturave në sistemin përkatës (248 lëndë).
- Barazimi i shpenzimeve dhe të hyrave me Free balance
- Dërgimi i formularit tremujorit 1 të rrjedhës së parasë për nënalokim tek z. Remzi Isufi.
- Dërgimi i formularit TM2, për nënalokimin e buxhetit nga kategoria të hyrat nga komuna për nivelin IP.
- Inicimi i aktiviteteve përmes zyrës së prokurimit:
- Përgatitja e marrëveshjeve dhe vërtetimeve për furnizim me derivate të transportuesve të nxënësve.
- Furnizimi i transportuesve të nxënësve me derivate.
- Furnizim me material higjienik për Institucionet Edukativo Arsimore dhe me letër A4.
- furnizime me material riparues teknik.
- Përgatitja e lëndës për pagesat e pagave të nëpunësve teknik kompania Tregu.
- Shkarkimi i dokumentacionit përkatës nga sistemi ATK për pagesat e kontributeve dhe tatimeve për punëtorët dhe qiranë e disa objekteve shkollore.
- Kërkesa të ndryshme ndaj operatorëve ekonomik lidhur me aktivitetet e furnizimit dhe shërbimit,
- E-finance janë proceduar 2013 lëndë,
- Janë inicuar 21 aktivitete prokurimi me vlerë totale prej, 1,272,299.00 euro

Shpenzimet gjashtë mujore për DKA dhe IEA-të

| Përshkrimi | Kategoria | Planifikim | Shpenzimi | Përqindja | Përqindja | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 92135 - DKA | | 2,072,778.66 | 623,182.02 | | - | - |
| | Paga | 129,999.99 | 57,165.69 | #REF! | 43.97 | |
| | Shërbime dhe mallra 10-21-22 | 1,307,000.00 | 540,758.04 | #REF! | 41.37 | |
| | Komunali 10-21 | 39,281.56 | 25,258.29 | #REF! | 64.30 | |
| | Subvencione 10-21 | 100,000.00 | | #REF! | - | |
| | Kapitale-10-21 | 496,497.11 | | #REF! | - | |

| Përshkrimi | Kategoria | Planifikim | Shpenzimi | Përqindja | Përqindja | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 92730 - Arsimi Para fillor Çerdhet | | 925,637.24 | 464,073.27 | | - | - |
| | Paga | 632,636.00 | 376,441.71 | #REF! | 59.50 | |
| | Shërbime dhe mallra 10-21-22 | 260,001.24 | 78,186.36 | #REF! | 30.07 | |
| | Komunali 10-21 | 33,000.00 | 9,445.20 | #REF! | 28.62 | |
| Përshkrimi | Kategoria | Planifikim | Shpenzimi | Përqindja | Përqindja | Vërejtje |
| 93780- Arsimi Fillor | | 8,088,869.12 | 4,724,322.82 | | - | - |
| | Paga | 7,363,486.70 | 4,521,070.03 | #REF! | 61.40 | |
| | Shërbime dhe mallra 10-21-22 | 630,382.42 | 167,037.92 | #REF! | 26.50 | |
| | Komunali 10-21 | 95,000.00 | 36,214.87 | #REF! | 38.12 | |
| Përshkrimi | Kategoria | Planifikim | Shpenzimi | Përqindja | Përqindja | Vërejtje |
| 94980 - Arsimi i Mesëm | | 3,383,083.00 | 1,580,306.43 | | - | - |
| | Paga | 2,955,082.98 | 1,516,127.77 | #REF! | 51.31 | |
| | Shërbime dhe mallra 10-21-22 | 380,000.02 | 47,370.83 | #REF! | 12.47 | |
| | Komunali 10-21 | 48,000.00 | 16,807.83 | #REF! | 35.02 | |

**Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike dhe Personel në Arsim**
**01.01.2023 – 30.06.2023**

- Vendime/Aktvendime të ndryshme, 73.
- Hartimi dhe përgjigje në kërkesa/parashtresave palëve, 83.
- Hartimi i kontratave të punës, 144.
- Hartimi i akteve të tjera shkresore, 102.

- Hartimi i shkresave të ndryshme, drejtuar Institucioneve publike dhe subjekteve të tjera brenda dhe jashtë Komunës së Gjilanit, 18.
- Hartimi dhe shpallja e konkurseve për Drejtorë të IEAA-ve, pesëmbëdhjetë (15) vende të punës.
- Hartimi dhe shpallja e konkurseve për mësimdhënës, nëntëmbëdhjetë (19) vende të punës.
- Hartimi dhe shpallja e konkurseve për Psikolog/e, dhjetë (10) vende të punës.
- Përgatitja, plotësimi dhe procedimi i formularëve për ndryshimet në listat e pagave, drejtuar thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, 182.
- Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë janë pranuar dhe protokolluar 280 lëndë, drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit.
- Hartimi i Projekt Rregullores për Marrëdhënien Juridike të Punës në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese.
- Hartimi i Projekt Rregullores për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Punonjësve në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese.
- Hartimi i Projekt Rregullores për mbështetjen financiare - bursave të posaçme për studentët e shkëlqyer të Komunës së Gjilanit, që studiojnë jashtë shtetit të Republikës së Kosovës (Fondi i Ekselencës).
- Organizimi i brendshëm i dëgjimeve publike për Projekt Rregulloret.
- Mbajtja e takimeve të vazhdueshme me Sekretarët dhe Administratorët e të gjitha Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Aftësuese lidhur me çështjet ligjore administrative të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë ndërmjet DKA-së dhe IEA-ve.
- Ofrimi i shërbimeve ligjore dhe administrative për komisionin e ankesave të formuar nga Drejtoria e Arsimit.
- Ofrimi i shërbimeve ligjore dhe administrative për komisionin disiplinor të formuar nga Drejtoria e Arsimit.
- Ofrimi i shërbimeve ligjore dhe administrative për komisionin e rekrutimit dhe përzgjedhës të Drejtorëve të IEAA-ve si dhe stafit mësimor.
- Ofrimi i dokumentacionit dhe bashkëpunimi me auditorin e Jashtëm dhe të brendshëm.
- Bashkëpunimi me Drejtoritë e Administratës Komunale, Institucionet Lokale dhe të nivelit qendror.

## 4. DREJTORIA BUXHET DHE FINANCA

- Pasqyrat vjetore 2022 për MFPT,
- Raportin financiar 2022 për Kuvend ,
- Raportin financiar tremujorit parë për Kuvend
- Kornizën afatmesme buxhetore 2024-2026

- Rrjedhën e parasë (plani i keshit) për të gjitha njësit buxhetore dhe gjitha kategoritë ekonomike dhe atë në fillim të vitit dhe korrigjimet muajin prill
- Shpërndarja e mjeteve të bartura nga viti 2022
- Formimi i dokumentacioni për kode të projekteve dhe alokimin e tyre nga MFPT
- Analiza e alokimeve buxhetore si p.sh. raporti i alokimeve për Paga Mëditje, Mallra Shërbime, Komunali, Investime Kapitale dhe Subvencione.
- Kemi punua nënalokimet mujore për Paga&Meditje, Mallra&Shërbime dhe Komunali për çerdhet, arsimin fillor dhe të mesëm (analitikë për çdo çerdhe, konvikt dhe shkollë).
- Analiza e Paga &Mëditje për të gjitha programet buxhetore.
- Formimin e dokumentacionit nga participimet dhe donacionet për rritje të buxhetit dhe alokimin e mjeteve.
- Bashkëpunimi i ngushtë me auditorët e jashtëm
- Pranojmë të gjitha raportet e të hyrave nga BQK
- Përpunojmë të gjitha të hyrat sipas kodeve dhe drejtorive.
- Regjistrojmë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet në SIMFK.
- Përgatisim për të gjitha drejtoritë raporte të të hyrave mujore (6 raporte).
- Bëjmë barazime ditore me BQK dhe bankat komerciale.
- Barazime mujore me MFPT-Thesar
- Përgatisim në baza ditore raporte për të hyrat për secilën drejtori(119 raporte).
- Përgatisim UNIREF-at për të gjitha faturat e drejtorive
- Mbajmë evidencë analitike për çdo lloje të hyre.
- Mbajmë evidencë analitike për të gjitha shpenzimet
- Shtypim listat e pagave të dërguara nga Menaxheri i zyrës së Personelit i dërgojmë për verifikim nga drejtorët përgjegjës dhe nënshkrim nga shërbyesit civilë me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i kryejnë vet.
- Në arkiv janë protokolluar 4801 lëndë
- Kemi bërë shpërndarjen e faturave të Tatimit në Pronë (23364 fatura) nga 27739 fatura
- Gjatë punës vjetore bëjmë shtypjen e faturave të Tatimit në Pronë me kërkesë të tatimpaguesve dhe lëshojmë vërtetime të ndryshme (4468 vetëtime).
- Janë regjistruar 199 objekte të reja.
- Deri në këtë periudhë kemi pranuar dhe shqyrtuar 97 Ankesa
- Janë nënshkruar 59 marrëveshje për pagës me këste të tatimit pronë
- Janë korrigjuar nga anketuesit të dhënat e pronës 1206 njësi të objekteve
- Gjatë kësaj periudhe buxhetore janë zotuar 2900 lëndë regjistruar si shpenzim 2681 lëndë, certifikuar, fotokopjuar dhe arkivuar në arkivin e thesarit komunal (2678 lëndë)

- Përcjellim regjistrimin dhe transferet e inventarit

| | Planifikimi 2023 | Realizimi i të hyrave janar qershor 2022 | Realizimi i të hyrave janar qershor 2023 | Krahasimi në mes të realizimit 2022 dhe 2023 | % në mes planifikimit dhe realizimit 2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| Të hyrat nga Tatimi në Pronë | 2.938.283,00€ | 1.205.136,01€ | 1.849.816,49€ | 153,49 | 62,96 |

Drejtoria për Buxhet dhe Financa:
-Pagat 86.645,25€
-Mallra dhe shërbime 9.937,97€
-Shpenzime komunale 1.715,46€
**Gjithsej shpenzimet: 98.298,68€**

## 5. DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM), në përputhje me kompetencat ligjore, planin vjetor të punës për vitin 2023, si dhe objektivave të përcaktuara në këtë plan, është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës.

Raporti pasqyron aktivitetet dhe rezultatet e të gjithë sektorëve të DUPMM-së duke u fokusuar në fushat e planifikuara, të cilat përbëjnë objektivat e punës së drejtorisë sipas planit vjetor të punës për vitin 2023.

Raporti bazohet në të dhënat periodike të sektorëve të DUPMM-së dhe komisioneve, përkatësisht:

- Sektorit për Punë të Përgjithshme Juridike,
- Sektorit të Urbanizmit,
- Sektorit të Planifikimit,
- Komisionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së I-rë.

Gjatë këtij gjashtë mujori janar-qershor 2023,Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka pranuar për shqyrtim **324 kërkesa**.

**Statusi i lëndëve të pranuara për shqyrtim nga Qendra për Shërbim me Qytetar dhe Arkivim**

Gjatë këtij gjashtë mujori janar-qershor 2023,Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka punuar gjithsej **866 akte**, ndërsa në vitin paraprak, (nga data 01 janar 2022 – 15 qershor 2022), kjo drejtori ka punuar gjithsej **308 akte**. Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak, në vitin 2023, ky organ ka nxjerr **558 akte më shumë në vitin 2023**, e që shprehur në përqindje është **281.17 %.**

| **Nr.** | **Klasifikimi i lëndëve** | |
|---|---|---|
| 1 | Lëndë të kompletuara | 224 |
| 2 | Lëndë të pa kompletuara | 100 |
| | **Gjithsej:** | **324** |

**Grafikoni 1**




**Lloji i akteve të përpunuara:**

| Nr. | Emërtimi i aktit | |
|---|---|---|
| 1 | Vendime për lejimin e ndërtimit – Leje ndërtimore | **56** |
| 2 | Vendime për përcaktimin - Miratimin e kushteve ndërtimore | **32** |
| 3 | Vendime për lejimin e rrënimit – Leje rrënimi | **8** |
| 4 | Vendime për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale | **6** |
| 5 | Vendime për përfundimin e procedimit administrativ | **62** |

| | | |
|---|---|---|
| 6 | Vendime për dhënien e certifikatës së përdorimit | **1** |
| 7 | Vendime për dhënien e certifikatës së legalizimit | **329** |
| 8 | Vendime për përfshirje në listë të pritjes | **63** |
| 9 | Vendime për leje legalizimi | **6** |
| 10 | Vendime për lejimin e riparimit të objekteve | **2** |
| 11 | Vendime për korrigjimin e akteve administrative | **12** |
| 12 | Vendime për plotësimin - ndryshimin e akteve administrative | **2** |
| 13 | Vendime për zgjatjen e vlefshmërisë së akteve administrative | **2** |
| 14 | Vendime për shtyrjen e ekzekutimit të akteve administrative | **1** |
| 15 | Vendime për pezullimin e procedurës administrative | **7** |
| 16 | Vendime refuzimi | **3** |
| 17 | Vendime për ndryshimin e përbërjes së komisioneve | **1** |
| 18 | Pëlqime për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore | **2** |
| 19 | Pëlqime për parcelim | **50** |
| 20 | Ekstrakte | **48** |
| 21 | Njoftime, lidhur me prezantimin e dokumentacionit | **99** |
| 22 | Konfirmime mbi pranimin e shkresave | **8** |
| 23 | Përgjigje në kërkesë | **25** |
| 24 | Përgjigje në kërkesa për qasje në dokumente publike | **7** |
| 25 | Dërgim i lëndës për shkak të jo kompetencës, organit kompetent | **7** |
| 26 | Dërgim i ankesës me shkresa përcjellëse në MMPH | **1** |
| 27 | Informata | **16** |
| 28 | Kërkesa | **6** |
| 29 | Njoftime | **2** |
| 30 | Autorizime | **2** |
| | **Gjithsej:** | **866** |

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe të raportimit, ky organ ka pranuar për shqyrtim **324** kërkesa, ndërsa siç është cekur më lartë, ka nxjerr **866 akte**, krahasuar me numrin e kërkesave të pranuara, ky organ ka nxjerr **542 akte më shumë** sa ka pranuar kërkesa, e që shprehur në përqindje është **267.28 %.**

**Grafikoni 2.**




**Raporti përmbledhës i të hyrave dhe shpenzimeve të D.U.P.M.M-së për periudhën Janar - Qershor 2023**

| **Nr.** | **Përshkrimi** | **Realizimi 2022** | **Planifikimi 2023** | **Realizimi 2023** | **Index (3:1)** | **Index (3:2)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **A** | **Të hyrat** | **1** | **2** | **3** | | |
| **1** | **Të hyrat nga Lejet Ndërtimore** | **195,354.60** | **800,000.00** | **735,741.67** | **377%** | **92%** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Të hyrat nga Taksat - Kërkesat** | **821.00** | **2,000.00** | **740.00** | **90%** | **37%** |
| 3 | **Të hyrat nga Legalizimet** | **17,135.76** | **50,000.00** | **37,968.59** | **222%** | **76%** |
| 4 | **Të hyrat nga Lejet Mjedisore** | **19,528.00** | **63,000.00** | **17,257.00** | **88%** | **27%** |
| 5 | **Të hyrat nga Rrënimet e objek.** | **1,797.51** | **5,000.00** | **2,205.16** | **123%** | **44%** |
| | **Gjithsej (1+4)** | **234,636.87** | **920,000.00** | **793,912.42** | **338%** | **86%** |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| **B** | **SHPENZIMET** | | | | | |
| 1 | **Mallra dhe Shërbime** | **11,385.82** | **390,000.00** | **40,013.05** | **351%** | **10%** |
| 2 | **Komunalit** | **4,193.28** | **7,000.00** | **4,637.00** | **111%** | **66%** |
| | **Gjithsej (1+2)** | **15,579.10** | **397,000.00** | **44,649.75** | **287%** | **11%** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| C | **Investimet Kapitale** | **25,000.00** | **50,000.00** | **0.00** | | |

Aktivitet e realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, kanë rezultuar me inkasim të vlerës monetare **793,912.42 euro,** që është:

1) **559,275.55 euro** më shumë se në të njëjtën periudhë raportuese të vitit paraprak, shprehur në përqindje është **338%.**




**2)** Planifikimi i realizimit të të hyrave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 ka qenë **503,450.00 euro**, janë realizuar **793,912.42 euro,** që është për **290,462.42 euro** më shumë se sa që janë planifikuar, shprehur në përqindje është **157.69%.**



**3)** Planifikim i projektuar i të hyrave për tërë vitin 2023, në DUPMM është **920,000.00** euro. Vetëm në gjashtëmujorin e parë janë realizuar inkasim në vlerë **793,912.42 euro,** shprehur në përqindje është **86%.**




## 6. DREJTORIA E INSPEKCIONIT

**Sfera e ndërtimit**

- 6M1/2023 janë hartuar 111 procesverbale, ndërsa në 6M1/2022 janë 102,
- 6M1/2023 janë 02 aktvendime për ndërprerje të punimeve, ndërsa në 6M1/2022 janë 13;
- 6M1/2023 janë 272 përgjigje ndaj kërkesave, ndërsa në 6M1/2022 janë 235;
- 6M1/2023 janë 52 leje ndërtimi, ndësa në 6M1/2022 vetëm 33;
- Është ngritur vetëdijesimi i qytetarëve per t'u pajisur me leje të ndërtimit.
- Ndërtimet e larta janë të gjitha nën kontroll, pasiqë për çdo etazhitet kërkohen matjet gjeodezike,

- Bëhet përcjellja e vazhdueshme të ndërtimeve nga inspektorët e cila është duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së ndërtimit.

| Nr. | Përshkrimi i punës | Janar-qershor 2023 |
|---|---|---|
| 1. | Procesverbale | 111 |
| 2. | Aktvendime për ndërprerje të punëve | 02 |
| 3. | Përgjigje ndaj kërkesave | 272 |
| 4. | Përgjigje ndaj ankesave | 04 |
| 5. | Leje ndërtimi të pranuara nga dupmm | 52 |
| 6. | Vendime për leje rrënimi të lëshuara nga dupmm | 10 |
| 7. | Vendim për cakt. E kusht. Ndërt. (dupmm) | 27 |
| 8. | Certifikatë për përdorim të objektit (dupmm) | 01 |
| 9. | Gjoba | 03 |
| 10. | Ndërprerje të punëve | 03 |
| 11. | Vendime për pezullim të procedurave të lëshuara nga dupmm | 08 |
| 12. | Refuzim (të lëshuara nga dupmm) | 01 |

**Sfera e tregut**

- 6M1/2023 janë inspektuar 327 biznese, ndërsa në 6M1/2022 janë 160, - ka pasur ngritje këtë vit për arsye të hapjeve të bizneseve të reja;
- 6M1/2023 janë hartuar 363 procesverbale, ndërsa në 6M1/2022 janë 136, - ka pasur ngritje për arsye të kërkesave nga Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë;
- Është bërë inspektimi i subjekteve afariste të cilat nuk janë të pajisura me çertifikatë të regjistrimit të bizneseve apo ato të cilat nuk janë të pajisura me pranim teknik të lokaleve ndërsa 6M1/2023 janë 115 pranime të kushteve minomalo-teknike, ndërsa në 6M1/2022 janë 92;

- Është bërë kontrollimi i artikujve me standarde europiane, dokumentacioni i konformitetit të mallit në subjektet të cilat posedojnë produkte.

| Nr. | Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre | |
|---|---|---|
| 1. | Inspektime pa procesverbale dhe (vizita kthyese) | 327 |
| 2. | Inspektim me procesverbale | 363 |
| 3. | Procesverbaleve te pranimeve teknike | 115 |
| 4. | Shuma e parave nga pranimet teknike | 8,617.00 € |
| 5. | Kërkesa të refuzuara të pranimeve teknike | 00 |
| 6. | Numri i gjobave mandatore | 05 |
| 7. | Lëndë për Gjykatë | 02 |
| 8. | Përgjigje të ankesave | 13 |
| 9. | Aksione me Policinë e Kosovës (kujdestari) | 01 |

**Sfera e Komunikacionit**

- Janë hartuar 92 procesverbale në 6M1 të 2023 krahasuar me vitin 2022 ku ishin vetëm 32.
- Janë iniciuar 24 kundërvajtje në 6M1 të 2023 krahasuar me vitin 2022 ku ishin vetëm 12.
- Janë inspektuar vijat komunale të cilat mbahen me autobus nga qyteti i Gjilanit në drejtim të fshatrave të cilat janë brenda territorit të komunës së Gjilanit,
- Janë inspektuar taksitë legale si dhe ato ilegale (ndaj taksive ilegale janë iniciuar 24 kundërvajtje),
- Janë inspektuar transporti i cisternave të cilat transportojnë materie të rrezikshme, etj.

**Raporti detal për inspeksionin e komunikacionit:**

| Nr. | Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre | 2023 |
|---|---|---|
| 1. | Numri i procesverbaleve | 92 |
| 2. | Numri i kundërvajtjeve | 24 |
| 3. | Numri i konstatimeve | 36 |
| 4. | Numri i vërejtjeve | 26 |
| 5. | Numri i rekomandimeve të dorëzuara në DSHPIB për rende të udhëtimit | 01 |
| 6. | Numri i kërkesave të pranuara | 05 |
| 7. | Numri i kërkesave të shqyrtuara | 05 |
| 8. | Numri i kërkesave të cilat janë në shqyrtim | 00 |
| 9. | Numri i ditëve të punës jashtë orarit + ditëve të vikendit | 12 |

**Sfera e Mbrojtjes së Mjedisit**

- Janë inspektuar subjektet të cilat janë të pajisura me Leje Mjedisore Komunale dhe është kontrolluar zbatimi i kësaj leje.
- Janë bërë rekomandime në DSHPIB për pastrim të disa lokacioneve në hapësira publike ku ka pasur të hedhura mbeturina.
- Inspektorët janë angazhuar edhe në orët shtesë – kujdestaritë për arsye të ndotjes akustike (zhurmës), ku është monitoruar zbatimi i Urdhëresës së Kryetarit për Mbrojtjen nga Zhurma.
- Janë pranuar kërkesa verbale dhe zyrtare për probleme të ndryshme në aspektin e mjedisit (hudhja e mbeturinave, derdhja e cfarëdo materiali në hapësira publike, inspektim për ndotjen e lumenjëve, ndotja akustike, etj.) për të cilat pas inspektimit në teren kemi lëshuar edhe aktet e nevojshme normative (përgjigje, vendime, gjoba etj).

| Nr. | Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre | |
|---|---|---|
| 1. | Numri i inspektimeve | 60 |
| 2. | Numri i procesverbaleve | 27 |
| 3. | Numri i kërkesave të dorëzuara në Gjykatën Themelore në Gjilan | 00 |
| 4. | Numri i shqiptimit të gjobava mandatore | 01 |
| 5. | Numri i kërkesave zyrtare të pranuara | 07 |

| | | |
|---|---|---|
| 6. | Numri i kërkesave zyrtare të shqyrtuara | 07 |
| 7. | Numri i kërkesave në shqyrtim | 00 |

**Sfera e shërbimeve publike**

- Është inspektuar shfrytëzimi i hapësirave publike,
- Ndërhyrjet në infrastrukturën publike,
- Kyçjet në rrjetin e kanalizimit dhe të ujësjellësit.
- Në 6M1 2023 janë shqiptuar 14 gjoba mandatore, ndërsa në 6M1 2022 vetëm 03,
- Në 6M1 2023 janë larguar 07 objekte të vendosura në hapësira publike, ndërsa në 6M1 2022 vetëm 3,
- Janë hartuar 103 procesverbale,
- Janë shqyrtuar 20 kërkesa.

| Nr. | Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre | |
|---|---|---|
| 1. | Numri i inspektimeve | 133 |
| 2. | Numri i inspektimeve me procesverbaleve | 103 |
| 3. | Numri i konstatimeve | 09 |
| 4. | Numri i vërejtjeve | 73 |
| 5. | Numri i gjobave | 14 |
| 6. | Numri i largimeve | 07 |
| 7. | Numri i kërkesave të pranuara | 20 |

## 7. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

- Përgatitja e projekteve të planifikuara për vitin 2023, ku ne si drejtori kemi paraparë qe 14 projekte të realizohen në subvencione, projekte kapitale dhe shërbime e mallra.
- Planifikimi i zotimeve dhe shpenzimeve nga burimet financiare, grandet për vitin 2023
- Dëgjimet publike me qytetarët në kuadër të komunës, ku edhe ne si drejtori e bujqësisë dhe pylltarisë  kemi prezantuar që të dëgjojmë nga afër nevojat, kërkesat dhe brengat e qytetareve e fermerëve në veçanti.

- Vërshimet në komunën tonë shkaktuan dëme edhe në sektorin e bujqësisë.
- Vizituam fshatrat Lladovë, Llashticë, Nasalë, Zhegër, Haxhaj, Demiraj, Isufaj, Pidiq e Shurdhan, zona të prekura nga vërshimet e fundit, duke pa nga afër dëmet e shkaktuara në fushat bujqësore.
- Të gjithë fermerët e Komunës së Gjilanit që janë prekur nga këto vërshime dhe u janë shkaktuar dëme në kulturat bujqësore, ju kemi bërë thirrje që të aplikojnë, ku pas komisionit të vlerësimit do t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe do t'i verifikojmë dëmet e shkaktuara të cilat dëme me shpresë do të kompensohen nga Ministria e BPZHR, sepse ne si drejtori nuk kemi buxhet për rastet e tilla.
- Vizitat në fermat blegtorale të komunës sonë me zyrtarët e drejtorisë, për të pa nga afër gjendjen e tyre.
- Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë do të vazhdojë të ketë prioritet fermerët e Komunës së Gjilanit, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies së tyre në çdo aspekt!
- Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ka organizuar trajnimin për pemëtarët. Trajnimi me titull "Krasitja e pemëve", ishte një ditor i ndarë në dy pjesë teorike dhe atë praktike.
- Pas trajnimeve për bletarët dhe pemëtarët, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ka mbajtur trajnimin për blegtorët e Komunës së Gjilanit. Menaxhimi i gjedhit qumështor që prodhon 30l. (litër) qumësht, ishte tema e trajnimit që u ligjërua nga profesorët e Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Në kuadër të Planit të punës për vitin 2023, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, do të organizojë edhe trajnime tjera për fermerët e Komunës së Gjilanit. Ligjërues të këtyre trajnimeve do të jenë profesorë të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, pas memorandumit për bashkëpunim të nënshkruar nga kryetari i Komunës, Alban Hyseni, me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Aplikim për farë misri kemi bërë ftesë publike për të gjithë fermerët e Komunës së Gjilanit të cilët janë kultivues të rregullt të misrit dhe mbjellin më pak se një hektar me misër.
- Inicimi i procedurave të projektit për "qentë endacak" dhe projekteve tjera të planifikuara për vitin 2023.
- Për vitin 2023, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka rrite buxhetin për subvencione, projektet kapitale dhe shërbime e mallra qind përqind si dhe kontaktet me organizatat e huaja si Islamik Relif, Katari, Tika të cilat shpresojmë që këtë vit do të kemi përkrahje si në mekanizëm bujqësor, serra të zinguara, mështjerra dhe pula vojse dhe në masë të kënaqshme do të ndihmojmë fermerët e Komunës tonë.
- Gjithashtu është kryer shpërndarja "Fara e misrit" për fermerët e komunës së Gjilanit.
- Komuna e Gjilanit ka shpërndarë të premten farë misri për 302 fermerë për mbjelljet pranverore.

- Komuna dhe drejtoria e bujqësisë dhe pylltarisë do të jenë gjithmonë afër fermerëve, për t’i subvencionuar ata me të gjitha kapacitetet komunale.
- I informuam fermerët se është bërë rritja e buxhetit për 100 për qind për subvencione, shërbime dhe mallra.
- Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan në bashkëpunim me Shoqatën e Bletarëve të Gjilanit ka organizuar ligjërata profesionale nga lëmia e bletarisë. Në këtë ligjërate morën pjesë rreth 130 bletarë nga Gjilani, Kamenica, Vitia, Ferizai, Prishtina, Peja, Deqani etj. Gjithashtu ishim prezent unë si drejtor dhe zyrtaretnga tjerë, drejtori i Laboratorit për analiza në Prishtinë Beqë Hulaj, zyrtarë nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari etj. Ndër temat që u shtjelluan ishin:
    - Ndikimi i bletëve në polenizimin e bimëve në përgjithësi e të boronicës në veçanti
    - Inseminimi artificial i bletëve, përparësitë dhe të metat
    - Seleksionimi natyral i MËMAVE
    - Të dhëna dhe studime në lidhje me askosferozën
    - Luftimi i varratozës etj.

**Sektori i Pylltarisë**

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Gjilan, prioritet i këtij sektori është parandalimi dhe ndalimi i prerjeve ilegale të pyjeve publike dhe private. Gjatë periudhës Janar –Mars, sektori i Pylltarisë ka organizuar kujdestaritë 24h, me qëllim të vetëm parandalimi dhe kapja e prerësve ilegal të pyjeve. Është shfaqur një dukuri ku pronarët e pyjeve private shesin malin e tyre recidivisteve dhe fillon prerja pa kontrolle e këtyre pronave nga prerësit ilegal në këtë raste si blerje dhe pa dokumentacionin e rregullt për prerje.
Do të sajojmë një raste të tillë në fshatin Cërnicë ku pronari ia ka shitur një masë të druve një prerësi ilegal, ku i njëjti ka filluar prerjen e pastër të pyllit. Fatmirësisht kemi intervenuar në fazën e parë të prerjes, ku kemi ndaluar prerjen dhe i kemi marr të gjitha masat ligjore ndaj pronarit të pyllit. Intervenimet e shpeshta ndaj këtyre rasteve ka ndikuar pozitivisht në vetëdijësimin e pronarëve të pyjeve private dhe si rezultat i kësaj nga janari deri në muajin mars, kemi mbi 350 kërkesa për prerjen e pyjeve private.

- Janë konfiskuar mbi 25 metra hapësinorë
- Janë konfiskuar mjete transportuese të llojit Pikap
- Janë shqiptuar 11 vendime për kundërvajtje
- 6 vendime penale me vlerën e drunjve 4.607.99 €

Sa i përket realizimit të sasisë drunore sipas licencave ose Tenderë të vitit 2023 pë shitje nga pyjet publike janë paraparë:

- Drunjë teknik - 201.00 $m^3$
- Drunjë zjarri - 763.90 $m^3$ ku totali është 964.90 $m^3$
- Nga këto deri në muajin mars janë realizuar 145.28 $m^3$ .

Sa i përket lejeve për prerjen e kontrolluar të pyjeve në pronësi private në tremujorin e parë janë dhënë 14 leje të vitit paraprak, të cilët nuk kanë arritur ta realizojnë prerjen në vitin e kaluar.
Sa i përket zjarreve nga muaji janar deri në muajin mars, sipas statistikës zyrtare kemi pasur 3 zjarre në Njësitë ekonomike
Dëmet kanë qenë të vogla, fal intervenimit të shpejt të pylltarëve dhe ekipit të zjarrfikëseve.
Gjithashtu janë paraparë edhe shitja me pakicë e masës drusore-trungjeve në këmbë nga pyjet publike në rajonin e Gadishit, Sllakocit, Përlepnicë apo Maja e Gjelbër dhe Zhegër për popullatën e rajonit me çmim 18.00€ për $m^3$, me qëllim që popullata e rajonit të caktuar të furnizohet me çmim të kapshëm, duke marrë parasysh vështirësitë ekonomike.

## 8. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

### I. Statusi i lëndëve në procedurë administrative

Tabela 1.1

| Nr. | | Nr. |
|---|---|---|
| **1** | Të arritura | 566 |
| **2** | Në proces | 116 |
| **3** | Të dalura nga DSHPIB-ja | 33 |
| **4** | Lëndët e miratuara (nga 01.01.2022 deri 30.06.2023) | 413 |

II. **Transporti**

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj duke përfshirë edhe transportin e rregullt të udhëtarëve me taksi dhe me autobus.

**Tabela 2. 2 Transportim me auto-taksi dhe me autobus**

| Nr | Përshkrimi | Nr |
|---|---|---|
| **1** | Numri taksistëve legal te cilët janë te pajisur me leje për operim brenda territorit te Komunës se Gjilanit deri me 30.06.2023 | 177 |
| 2 | Numri i kompanive që operojnë në transportin urbano-periferik (autobus), | 14 |

**III. Të hyrat financiare**: në Drejtorinë për Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim - gjatë kësaj periudhe janë realizuar të hyra financiare në vlerë:

Tabela 3 .3

| Nr. | Përshkrimi i të hyrave Financat | Vlera (euro) |
|---|---|---|
| **1** | Shërbimet Publike | 35,623.40 € |
| **2** | Regjistrimi i Automjeteve | 113,240.00 € |
| **3** | Qiraja Komunale | 34,558.16 € |
| | **GJITHSEJ:** | **183,421.56 €** |

| | EMËRTIMI I PROJEKTIT | VLERA E PARASHIKUAR | VLERA E KONTRAKTUAR | GJENDJA AKTUALE |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Gjelbërimi i hapësirave publike në Zonën e parë, dytë dhe tretë të qytetit të Gjilanit | **30,000.00** | | E implementuar |
| **2** | Ndriçimi publik i rrugës - nga rr. e Ferizajt – Cërrnicë - SH.P | **39,437.68** | **43,437.68** | Në proces të kontraktimit |
| **3** | Ndërtimi i rrugëve në afërsi të kolegjit në Gjilan | **137,215.00** | | E iniciuar për procedurë të tenderimit |
| **4** | Ndërtimi i rrugës Freskia në Gjilan | **25,866.00** | | Në proces të kontraktimit |
| **5** | Ndërtimin e rrugës Vaqe Zela dhe Hetë Koka - -Gjilan | **106,200.00** | | Proceduar të kontraktimit |
| **6** | Ndërtimin e trotuarit në fshatin Uglar - L = 1.50 161.00m | **140,784.00** | | Ri - Tenderim |
| **7** | Ndërtimi i rrugëve Muçibabë, Lipovicë, Depcë | **303,500.00** | | Procedurë të kontraktimit |
| **8** | Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Shurdhan | **87,000.00** | | Procedurë të kontraktimit |
| **9** | Asfaltimi i rrugës Balancë -Kravaricë | **125,800.00** | | Procedurë të kontraktimit |
| **10** | Mbjellja e luleve dhe fidaneve dekorative në Qytet | **20,000.00** | | E përfunduar |
| **11** | Rregullimi i Trotuarit dhe ndriçimit në fshatin Haxhaj - Demiraj (Bashkëfinancim) | **179,000.00** | **155,762.72** | Në implementim të projektit |
| **12** | Asfaltim i rrugëve në fshatin Malishevë e Ulët faza e dytë LOT 1 (Bashkëfinancim) | **174,000.00** | **142,193.00** | OSHP |
| **13** | Asfaltimi i rrugëve "Qefsere Salihu" dhe "Blerim Halili" LOT 2 (Bashkëfinancim) | **289,196.70** | **269,932.70** | OSHP |
| **14** | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Burnicë; LOT 3 (Bashkëfinancim) | **345,685.00** | **303,021.00** | OSHP |
| **15** | Asfaltim i rrugëve në lagjen Vishnjat pjesa e dytë-Bashkëfinancim LOT 4 (Bashkëfinancim) | **108,410.00** | **108,364.00** | OSHP |
| **16** | Mirëmbajta e rrugëve të rendit të tretë | **480,000.00** | **480,000.00** | OSHP |
| **17** | Renovimi i Parkut ekzistues afër stadiumit ndihmës të futbollit. | **33,094.72** | **42,591.88** | E përfunduar |
| **18** | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobërçan | **76,778.69** | | E iniciuar për procedure të tenderimit |
| **19** | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shillovë | **96,124.70** | | E iniciuar për procedure të tenderimit |
| **2** | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bresalc | **108,258.06** | | E iniciuar për procedure të tenderimit |
| **21** | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ponesh | **92,597.621** | | E iniciuar për procedurë të tenderimit |
| **22** | Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Shillovë - Zona lindore | **51,765.02** | | E iniciuar për procedurë të tenderimit |
| **23** | Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Kmetoc - zona lindore | **148,948.59** | | E iniciuar për procedurë të tenderimit |
| **24** | Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Bresalc | **95,186.722** | | E iniciuar për procedurë të tenderimit |
| **25** | Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Ponesh | **59,136.99** | | E iniciuar për procedurë të tenderimit |

**IV. Tërheqja e automjeteve me merimangë nga parkingjet ilegale**

Tabela **5.5**

| **Nr.** | | Numri i automjeteve |
|---|---|---|
| **1** | Gjatë kësaj periudhe janë tërhequr | 217 |

**2. Projektet – (kontratat që kanë vazhduar nga vitet paraprake) janë:**

**Mirëmbajta verore e rrugëve Tabela 2.3.**

**Mirëmbajtja teknike e objekteve**

Gjatë kësaj periudhe është intervenuar në mirëmbajtjen e këtyre objekteve:

| NR. | Punët e Realizuara për 6 mujorin e parë 2023 | Njësia | Sasia | Çmimi i njësisë | Vlera (€) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Asfaltimi i rrugës “Zejnulla Haliti”, | $M^2$ | 1,050.00 | me TVSH | 19,531.20 € |
| 2 | Asfaltimi i parkingut te QRA | $M^2$ | 1,511.20 | // | 14,450.80 € |
| 3 | Rruga dhe trotuari lagjja Dheu i Bardhe | $M^2$ | 1,176.00 | // | 32,152.20 € |
| 4 | Hapja e themelit te Çerdhja “Ardhmëria” | $M^2$ | 130.00 | // | 17.236.00€ |
| 5 | Rregullimi i rr. “28 Nëntori” | $M^2$ | 157.00 | // | 2,970.00 € |
| 6 | Sanimi i gropave dhe rregullimi i kapakëve | $M^2$ | 1,796.60 | // | 27,677.05 € |
| 7 | Shtrimi i shtegut te Parku, para Kristalit pengesa në rrugë dhe pusetave | $M^2$ | 176.00 | // | 4,393.30 € |
| 8 | Furnizimi i Gypave të betonit tek rr. Gjilan – Kamenicë | $M^2$ | 310.00 | // | 4,780.00 € |
| 9 | Hapja dhe rregullimi i Rrugës | | 320.00 | // | 4,522.00 |
| | **Total:** | // | // | // | **127,712.55 €** |

**1.** SHFMU “ Rexhep Elmazi” - rregullimi i hapësirave për rreth shkollës (oborrit), muret, shtegu për nxënës.

**2.** Aneksi i Çerdhja /SHFMU “Thimi Mitko” – Hidroizolimi, drenazhimi, rregullimi i oborrit, suvatimi/renovimi i hapësirave të brendshme

**3.** Adaptimi/Renovimi i Ambulantes së vjetër për Administratën e Policisë;

**4.** Kanë përfunduar nyjet sanitare në SHFMU “Abaz Ajeti” dhe

**5.** Rregullimi i dyerve në Shkollën Fillore (bibliotekën) e fshatit Llashticë.

**Ndriçimi publik në qytet:**

**1.** Zgjerim të rrjetit të ri është bërë në Porodinë.

**2.** Intervenime sipas kërkesave të banorëve

**Ndriçimi publik në fshatra:**

**1.** Zgjerim ka pasur vetëm në fshatin Livoç i Ulët, Vërbicë të Zhegovcit, Gumnishtë dhe Llashticë.

**2.** Intervenime sipas kërkesave të banorëve

**KRU Hidromorava:** janë bërë intervenimi në rr. "Avdulla Tahiri" dhe rr. "A. Presheva" për shkak të pëlcitjes së gypit të ujësjellësit – sipas kërkesës urgjente nga KRU "Hidromorava". është bërë hapja e pusetave të kanalizimit në fshatin Pogragjë dhe fsh. Bilinicë dhe disa pika sipas kërkesave të qytetarëve.

**Punë publike - projekte të vogla në Infrastrukturë**

| NR. | Punët e Realizuara për 6 mujorin e parë 2023 | Gjatësia | Çmimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Lagjja Zabel: rruga I, Gjilan | L = 90 m' | 5,467.00 € |
| 2 | Lagjja Zabel: rruga II, Gjilan | L = 120 m', | 14,107.70€ |
| 3 | Lagjja, Arbëri , | L = 181m ' | 9,309.00 € |
| 4 | Lagjja Fidanishte II, ; | L = 125m' | 5,438.00€ |
| 5 | Rr. "Agim Rashiti" | L = 30 m' | 1,130.76 € |
| 6 | Rruga 'Qarkore" – Gëzime Center | L = 45 m' | 1,820.50€ |
| 7 | Fashati Zhegër , ; | L = 325 m' | 18,533.75 € |
| 8 | Furnizimi me gypa të brinjëzuara në fshati Uglarë | L = 350 m" | 3,332.00 € |
| 8 | Lagjja - Dheu i Bardhë te SHFMU "Rexhep Elmazi', Gjilan | L= 132.50 m' | 5,905.10€ |
| | Totali: | | **65,043.81€** |

**3. Planifikimi i prokurimit për viti/2023 (gjashtëmujori i I- rë),**

**Projektet që janë në realizim nga viti i kaluar:**

| | **EMERTIMI I PROJEKTIT** | VLERA E KONTRAKTUAR | **GJENDJA AKTUALE** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1** | "Rruga në Lagjen Porodin kanalizimi fekal dhe ujësjellësi" | 84,003.98 | PORODIN: kanalizimi, ujësjellësi ka përfunduar. rruga është përgatitur, janë vendosë edhe anësoret, vetëm pritet të asfaltohet |
| **2** | "NDERTIMI I PARKUT BAJA – Ri - Tenderim" | 246,296.38 | Janë realizuar shumica e punëve te vrazhda, pjesët e mbetura janë punë estetike dhe elemente të parkut. Gjithashtu janë duke u përfunduar fushat e sportit që janë të parapara. |
| **3** | "Asfaltimi i rrugëve në lagjen Arbëria" | 165,480.25 | Projekti ka përfunduar gjatë 6 mujorit të pare 2023, |
| **4** | "Asfaltim i rrugëve në lagjen Vishnjet" | 194,672.95 | Kanë përfunduar punimet vetëm edhe një rrugë është në procedurë të implementimit |
| **5** | Kanalizimi fekal në fsh. Livoc i Epërm - Livoç i Ulet dhe një pjesë te Kodra e Thatë | 432, 773.00 | Kanë përfunduar punimet në gjatësi prej **L = 4,650 m**, dhe projekti është duke vazhduar |
| **5** | Asfaltimi i rrugës "Jonuz Tërstena", "28 Nëntori" dhe Krahët 1-5 | **266, 709.57** | Është duke u punuar në definimin e trasesë dhe vendosjen e zhavorrit 150 mm |

**Asfaltimi i rrugëve në lagjen Arbëria:**
Ka përfunduar projekti për ndërtimin- asfaltimin e rreth 1.50 km rrugë, kanalizim dhe ujësjellës.
**Rruga në lagjen Porodin kanalizimi fekal dhe ujësjellësi:**
Ka përfunduar ndërtimi i kanalizimi dhe ujësjellësit.
Rruga është përgatitur, janë vendosë edhe anësoret, vetëm pritet të asfaltohet.

## 9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Në DGJKP janë kryer këto punë dhe aktivitete si në vijim:

1. Janë pranuar nga **Qendra për shërbim me qytetarë:** kërkesa të ndryshme, për regjistrime të pronave, masa të përkohshme, barra tatimore, vlerësime të pronave për shqyrtimin e trashëgimisë, kontrata të ndryshme, kërkesa për matje, shënime për përmbaruesit privat, servitute, parcelime, azhurnime të bazës grafike, kërkesa për vektor, bashkime parcelash, përcaktim kufiri, rregullim kufiri etj.

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit |
|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Janar–Qershor 2023 | |
| 1. | Lëndët – kërkesat e pranuara | **3135 lëndë** | |

2. Janë kthyer në Qendrën për shërbim me qytetarë si të përfunduara :

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit | |
|---|---|---|---|
| | | Janar–Qershor 2023 | |
| 1. | Lëndët e kryera | **3637 lëndë** | |

**VËREJTJE: Siç po shihet nga tabelat e mësipërme, numri i lëndëve të kryera është për 682 lëndë më tepër se sa që janë pranuar gjatë këtij gjashtëmujori. Ky dallim është për faktin se gjatë kësaj periudhe janë kryer lëndët nga tremujori i fundit të vitit paraprak (2022), ku si pasojë e mungesës së stafit –*për shkak të pensionimit të gati 1/3 e stafit* – ka pasë një ngecje në kryerjen efikase të lëndëve.**

2. Në procedurë janë:

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit | |
|---|---|---|---|
| | | janar–qershor 2023 | |
| 1. | Lëndët në procedurë | **180 lëndë** | |

**VËREJTJE: Ky numër i lëndëve në procedurë pritet të përfundohen gjatë këtij muaji korrik/2023, sepse për to janë nxjerr aktvendimet të cilat tani janë në fazën e aprovimit.**

3. Kërkesa për regjistrim dhe fshirje të hipotekave:

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit | |
|---|---|---|---|
| | | janar–qershor 2023 | |
| 1. | Kërkesa për regjistrim dhe fshirje të hipotekave | **191 lëndë** | |

**VËREJTJE: Aplikacionet për regjistrime dhe fshirje të hipotekave parashtrohen në sistemin on-line nga Bankat të cilat veprojnë në Kosovë. Ato kryhen me prioritet dhe në mënyrë shumë efikase vetëm atëhere kur janë të pajisura me dokumentacionin valid i cili parashihet me ligj.**

4. Kërkesa për regjistrim dhe fshirje të Barrave Tatimore:

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit | |
|---|---|---|---|
| | | janar–qershor 2023 | |
| 1. | Kërkesa për regjistrim dhe fshirje të barrave tatimore | **15 lëndë** | |

**<u>VËREJTJE</u>: Aplikacionet për regjistrime dhe fshirje të barrave tatimore parashtrohen në sistemin on-line nga Institucionet kompetente të cilat veprojnë në Kosovë. Ato kryhen me prioritet dhe në mënyrë shumë efikase vetëm atëhere kur janë të pajisura me dokumentacionin valid i cili parashihet me ligj.**

5. Kërkesa për regjistrim e objekteve të legalizuara në procedurën e legalizimit:

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit | |
|---|---|---|---|
| | | janar–qershor 2023 | |
| 2. | Kërkesa për regjistrim e objekteve të legalizuara në procedurën e legalizimit | **205 lëndë** | |

6. Përveç kërkesave të palëve janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare :

| Nr. rend. | Përshkrimi i aktivitetit | Periudha e raportimit | |
|---|---|---|---|
| | | janar–qershor 2023 | |
| 1. | Certifikata të pronës | 4300 | |
| 2. | Certifikata të gjendjes ekonomike | 350 | |
| 3. | Certifikata që nuk posedon pronë | 90 | |
| 4. | Kopje plani | 1400 | |
| 5. | Kërkesa sipas detyrës zyrtare | 120 | |
| | **Totali :** | **6260** | |

Përveç lëndëve përmes QSHQ –së, DGJKP-ja ka kryer edhe lëndë – kërkesa sipas detyrës zyrtare lidhur me :

- Janë inicuar 57 lëndë sipas detyrës zyrtare për shqyrtimin, verifikimin, identifikimin dhe korrigjimin e të dhënave dhe sipërfaqeve në RDPP.
- Sponzorizimi i Vendimeve për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal, si : Shpallja me ineteres publik të parcelës në ZK Dobërçan e cila administrohet nga AKP-ja e për nevoja të banorëve të fshatit Dobërçan për fushë të futbollit, puse për ujë si dhe një pjesë për varreza të fshatit.
- Shpallja e Interesit Publik për lokacionin e Varrezave të Qytetit në ZK Shillovë ;
- Caktimi i lokacionit për Kampusin e Universitetit Publik “Kadri Zeka” – Gjilan, ZK Livoç i Epërm,

- Parcelimi dhe regjistrimi i pronave në procedurën e shpronësimit sipas projekteve të nivelit qendror e në të cilat interferohet Komuna e Gjilanit;
- Fillimi i procedurës së shpronësimit për nevoja të Projektit “Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi-pjesa mbi lumin Stanishorka” sipas PRRU “ Livadhet e Arapit” ZK Gjilan.
- Fillimi i procedurës së shpronësimit për nevoja të shtrimit të kanalizimit dhe hapjes së mini kolektorëve (pusetave) për nevoja të Projektit kryesor “Impianti i Ujrave të Zeza”. Janë përfshi 150 ngastra kadastrale të shpërndara në 5 zona kadastrale: ZK Gjilan; ZK Malishevë; ZK Uglar; ZK Velekincë dhe ZK Livoç i Ulët. Jemi në fazën e vlerësimit të këtyre pronave ;
- 8 Vendime përfundimtare për shpronësim (“Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi-pjesa mbi lumin Stanishorka” sipas PRRU “ Livadhet e Arapit” ZK Gjilan.)
- Janë realizuar të hyra vetanake për këtë periudhë (janar – qershor ): 120,244.33 € që në përqindje i bie 52.28% e mjeteve të planfikuara janë realizuar nga 230,000.00 € sa kanë qenë të planfikuara.
- Janë paguar në emër të kompensimeve të pronave të shpronësuara (janar –qershor): 1,454,696.71 € që në përqindje i bie 58.19 % të mjeteve të planifikuara për investime kapitale të drejtorisë për vitin 2023 i cili ka qenë 2,500,000.00 €.

## 10.DREJORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në periudhën gjashtë mujore janar-qershor të vitit 2023, aktivitetin e saj e bazon në Planin e Punës së DMSH-së.

Ecuria e punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) mbështetet, në rregulloret dhe ligjet në fuqi, si në:

Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me nr;04/L-027;

Ligjin e Mbrojtjes nga Zjarri nr 04/L-012,

Ligjin për Zjarrëfikje dhe Shpëtim me nr: 04/L-049,

Ligjin përkatës Komunal, Udhëzimet, Rregulloret përkatëse të lëmisë së emergjencave, të cilat kanë fushë veprimtarinë në menaxhimin e situatave emergjente duke bërë identifikimin, lajmërimin dhe alarmimin me kohë të situatave të cilat kanë të bëjnë me rrezikun e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale në Komunën tonë, për të cilën veprimtari ka hartuar edhe plane konkrete si Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut, Planin Operativ Emergjent, plane kontingjente etj.

Duke u bazuar në përgjegjësitë e saja DMSH, ka marrë masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe ka përcjellë aktivitetet e subjekteve relevante duke bërë koordinimin me to varësisht nga karakteri, lloji dhe përmasat e fatkeqësisë – shkallës emergjente.

Puna e drejtorisë është në varësi nga faktorët natyror, por edhe faktorëve të tjerë, njerëzor dhe teknologjik, andaj edhe bëhet sipas intensitetit që përcaktohet nga kushtet e përgjithshme shoqërore dhe klimatike.

Prandaj, në kuadër të tërë kësaj, paraqesim raportin sipas kronologjisë së zhvilluar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Në periudhën 6 mujore janar-qershor 2023 në DMSH, janë realizuar këto aktivitete:

- Aktivitetet janë realizuar sipas planit të punës për vitin 2023 bazuar në objektivat e DMSH-së
- Përgatitjet për realizimin e planit të punës për vitin 2023 bazuar në objektivat e DMSH-së
- Pas paralajmërimit për vërshime nga ana e IKHM, kemi marre masat dhe kemi angazhuar operatorin e kontraktuar për të bërë pastrimin lumit Stanishor, aty ku me herët ka pasur vërshime. Me këtë rast operatori gjate tri ditëve ka pastruar disa pika dhe fokusi kryesore ka qene afër urës ne rrugën Gjilan- Malishevë gjatësi rreth 300m, ( afër pishinës ,,Hawaii,) pastaj në hyrje të fsh.Malishevë, në Fsh.Livoç i Ulët si dhe te Qendra e Shëndetit Mental.
- NJPZSH ka dërguar një ekip në mbështetje të ekipeve emergjente në Mitrovicë për të ndihmuar në pompimin e ujit këtë qytet nga vërshimet.
- Është bërë vlerësimi i stafit të DMSH-së.
- Zhytarët e DMSH gjatë gjithë natës 23/24 janar, kanë monitoruar gjendjen në komunë për shkak të reshjeve të shtuara. Situata ka qenë e menaxhueshme dhe nuk ka pasur vërshime, me përjashtim të dëmtimit të disa urave të improvizuara ( Gypave) f.sh Stublinë - Pogragjë dhe Zhegoc.
- Kemi përgatitur planin dhe raportimin në dëgjimin publik të realizuar me dt.27 janar.
- Janë iniciuar dy procedura të prokurimit për nevojat e NJPZSH.
    1. Pushka Impulsive
    2. Furnizimi me pluhur për aparatet e zjarrfikjes.
- Pjesëmarrja në punëtorinë ,,Hartimi i Planit të Integritetit,, (16.02.2023).
- Procedura të prokurimit për nevojat e NJPZSH.
- Aktiviteti ,,Pastrimi i Lumenjve,,
- Është anuluar procedura e prokurimit për aktivitetin ,,Pushka Impulsiv,, dhe sipas njoftimit te zyrës së prokurimit i njëjti do të vazhdojë sapo të marrin përgjigje nga OSHP.
- Kemi marrë pjesë në punëtoritë:
    1. Punëtoria me USAID,, Prezantimi i rezultateve të gradimit,, Drejtori i DMSH (06 Mars 2023).
    2. Punëtoria me UNDP ,, Cilësia e ajrit,, një zyrtar i DMSH, 07 Mars 2023
    3. Punëtoria ,,Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore,, tre zyrtarë të DMSH, 15 Mars 2023.
- NJPZSH dhe DMSH ka mbështetur me një donacion njësinë e zjarrfikësve nga Tirana (Helmeta, veshmbathje dhe bombola te oksigjenit)
- Takimi i grupit punues pre hartimin e dokumentit VRR me 29 mars 2023.
- Janë zhvilluar Procedura të prokurimit për nevojat e NJPZSH.

- Aktiviteti i prokurimit „Pastrimi i Lumenjve„
- Mbledhja e grupit punues për hartimin e dokumentit të VRR.
- Angazhimi i DMSH me 03/04 prill ne monitorimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshimet. Gjithashtu NJPZSH ka qene e angazhuar në 4 shtëpi ku ka bërë pompimin e ujit si dhe ka bërë evakuimin e një familje me 5 anëtarë.
- Kemi bërë inspektimin e ujë lëshesave në rrugën Gjilan-Bujanoc te „Hib Petrol„ për të parë a janë vendosur ujë lëshesat në këtë segment rrugor në ndërtim.( Ujë lëshesat janë vendosur nga pune kryesi).
- Kemi mbajtur konferencën për media për të prezantuar raportin tre mujor të aktiviteteve ne DMSH.(20.04.2023).
- Kemi mbajtur mbledhjen e dytë të KKSB më 28 prill
- Kemi vazhduar me grumbullimin për hartimin e dokumentit të VRR.
- Planifikimi i buxhetit për 2024 dhe dorëzimi në DF.
- Kemi ngritur gatishmërinë pas paralajmërimeve të IKHM për mundësinë e vërshimeve
- Bashkë me kryetarin, kryesuesin e kuvendit dhe asamblistët komunal, si dhe me zyrtarët e DMSH kemi vizituar fsh.Pogragjë dhe Sllubicë për të parë nga afër shkallën e dëmtimeve nga vërshimet të urave dhe rrugës në këto fshatra pas reshjeve të shiut.
- Gjithashtu në Fsh.Nasale lumi “Morava” ka dale nga shtrati dhe ka vërshuar disa livadhe dhe ara të mbjella me grurë.
- Në fsh.Isufaj për shkak të ngritjes së nivelit të lumit nga reshjet e shiut, ura është bllokuar nga materialet e ndryshme dhe nuk ka qenë e qasshme për banorët.
- Kompania kontraktuese me 15 qershor ka bërë zhbllokimin e urës dhe është bërë e mundur që të shpëtohet nga dëmtimi si dhe qasja e banorëve në dy anët e lumit.
- DMSH në koordinim me DSHPBI pas reshjeve të shiut dhe vërshimeve nga data 19-23 qershor, kanë angazhuar kompaninë kontraktuese ku janë funksionalizuar urat e dëmtuara në fsh.Pogragjë, në lagjen Kacabaq dhe Sllubicë si dhe është rregulluar rruga afër varrezave të fsh.Sllubicë e cila ishte e dëmtuar ku është bërë e mundur përsëri qasja e banorëve të bllokuar nga dëmtimi i saj.
- Kemi realizuar aktivitetin në kuadër të projektit „ Fushatë vetdijësuese kundër zjarrvënës në fsh.Livoç i Epërm, DMSH, NJPZSH, PK KLSP DBP (23qershor). Ky aktivitet do të vazhdoj edhe në lokalitete tjera të komunës gjatë ditëve në vijim dhe në muajin korrik.

Takimet- Vizitat:

- Janë realizuar takime pune të rregullta me kryetarin, drejtorët etj. për t’i bashkërenduar punët dhe aktivitetet.
- Takim i Bordit të drejtorëve.
- Takim me Komitetin për Mbrojtje dhe Shërbime Publike (10.02.2023)
- Takim me zyrtarët e AME dhe 112 rreth DVRR ( 21.02.2023)

- Takim me shoqatën e pensionisteve të TMK, FSK dhe simpatizantëve ,,Elita,, 02 mars 2023, si dhe është bërë nënshkrimi i marrëveshjes për zyrat e shoqatës më 10 mars 2023. Bashkë me kryetarin z,A.Hyseni kemi pritur një ekip nga AME rreth bashkëfinancimit të aneksit të garazheve për nevojat e NJPZSH dhe 112. (24.04.2023) Takimi i bordit të drejtorëve dhe zyrtarëve financiar, i realizuar nga USAID.(11.05.2024)
- Takimi për projektin ,,Parandalimi i dukurive të zjarreve,, DMSH,PK DBP.(12.05.2024)
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga OJQ ,,ELITA,, Ngritja dhe funksionimi i QOE dhe procesi i vendimmarrjes në QOE. 2 zyrtare të DMSH ( 31.05.2024
- Takimi i bordit te drejtoreve dhe zyrtareve financiar, i realizuar nga USAID.(11.05.2024) Takim i Bordit te Drejtorëve rreth KAB (06 qershor)
- Takimi i dytë për projektin ,,Parandalimi i dukurive të zjarreve,, DMSH, PK.(07 qershor 2024)
- Takim me banorët e fsh.Sllubicë pas vërshimeve dhe dëmtimit të urave mbi këtë lum. Banorët kanë kërkuar që të intervenohet në këto ura dhe rrugë.
- "Trajnim për bashkësitë fetare dhe anëtarët e këshillave komunale për siguri në bashkësi në parandalimin e incidenteve të sigurisë" /një zyrtar i DMSH (20 qershor)

**Raporti 6 mujor punës 01 janar –30 qershor 2023 i inspektorit të FNFT**

- Takime me grupin Punues si dhe mbledhja e te gjitha të dhënave nga drejtoritë si dhe agjensionet tjera; Dokumenti e Vlerësimit të Rrezikut për komunën e Gjilanit. Ky aktivitet vazhdon deri në përfundim të këtij dokumenti, jemi duke punuar dhe mbledhur të dhënat e drejtorive për të punuar dhe vendosur në dokumentin e ri.

- Inspektimi i objekteve lidhur me aplikimin e masave parandaluese nga FNFT **;**

- Në këtë muaj kemi kontrolluar Subjekte shtetërore dhe private në komunën e Gjilanit;
- SHFMU "Sadulla Brestovci" në Gjilan.
- Në këtë muaj kemi kontrolluar Subjekte shtetërore dhe private në komunën e Gjilanit;
- SHFMU 'Vesel Muja" në lagjen e Myhyrëve - Bresalc.
- SHFMU" Rexhep Elmazi" Lagjja dheu i Bardhë në Gjilan.
- Çerdhja IP '' Ardhmëria" që gjendet në Gjilan
- Shkolla e Muzikës dhe Arteve që gjendet në Gjilan.
- Qendra edukative " Don Bosko" që gjendet në Gjilan.
- Çerdhja IP " Integj" që gjendet në Gjilan
- Çerdhja IP " Ardhmëria" që gjendet në Gjilan.

- Çerdhja IEAPP “ Poema” që gjendet në Gjilan.
- Çerdhja IEAPP “ T – Nushe” që gjendet në Gjilan.
- Çerdhja IEAPP” Helle” që gjendet në Gjilan.
- SHFMU ‘Fetah Qerimi” fshati Verbicë e Zhegocit.
- SHFMU” Nazmi Haxha” në rrugën Nekibe Kelmendi në Gjilan.
- Çerdhja IEAPP ’’Mësonjëtorja Qirazi
- Çerdhja IEPP” Te Fjolla”
- Çerdhja IEAPP “ Bora”
- Hello Academy of education ShPK që gjendet në Gjilan

Këto objekte shkollore, nuk kanë plan për Reagim dhe Evakuim Emergjent, si dhe Atestet e rrufe pritësit dhe rrymës nuk i kanë të kontrolluara, duke e përjashtuar Qendrën Edukative Don Bosko.

Këtij raporti ia bashkëngjis edhe raportin e gjitha objektet e shkollave, çerdheve si dhe universiteti publik që gjinden në Komunën tonë.

**Rreziqe nga vërshimet dhe përmbytjet ;**

Gjatë muajit janar edhe pse kemi pasur reshje të mëdha, kemi pasur vërshime, lumi stanishorka në rrugën "Vëllezrit Maliqi, në rrugën Hajdar Hashani në hyrje të fshatit Malishevë.

Gjatë këtyre reshjeve më 24 janar janë dëmtuar tri ura të imrovizuara në lokacionin Pogragjë- Sllubicë .

Për këtë peridhë të vërshimëve në si drejtori kemi pranuar kërkesa për Komisionin vlerësus të dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive tjera;

Gjatë muajit janar kemi pranuar  gjithësej 24 kërkesa kryesisht për vërshime nga banorët e prekur.

Gjatë muajit shkurt kemi bërë këto aktivitete:

- Gjatë këtij muaji jemi marrur kryesisht me kërkesat e qytetrëve të Komunës së Gjilanit që janë prekur nga vërshimet e 14 dhjetor 2022.

Ne si komision kemi bërë kategorizimin e kërkesave si në vijim;

1. Dëme në objekt ndërtimor
2. Dëme në pajisjet në pronësi të personave juridik
3. Dëme në të mira matriale
4. Dëme në bujqësi

Komisioni për vlersimin e dëmeve nga vërshimet e reshjeve atmosferike gjatë vizitave në terren, kemi vërejtur se ka pasur dëme të vogla në objektet ndërtimore dhe dëme në të mira tjera matriale.

Vlera e dëmeve nga vërshimet e reshjeve atmosferike për 20 aplikus sipas komisionit është vlera 23.406.00 €, kurse për 8 aplikues të tjerë nuk kanë dëme gjatë vërshimeve.
- Gjatë muajit mars edhe pse kemi pasur reshje të mëdha nuk kemi pasur vërshime të mëdha por vetëm në këtë lokacion te vendi i quajtur të Bunari i Përlepnicës, si pasojë e uzurpimit të përrockave kemi dëme në shtëpinë e Halim Tasimit dhe në Ballkan Auto Garage.

**Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përgjigjeje/ kërkesa, njoftime;**

- Faik Shkodra nga lagjja e fshatit Kmetoc, njoftim.
- Fatima Bekteshi nga Gjilani, njoftim.
- Armen Asani Gjilan, njoftim.
- Shkelzen Kastrati Gjilan, njoftim.
- Zjadin Uruqi Bresalc, njoftim.
- Selim Sherifi nga fshati Lladovë Komuna e Gjilanit, njoftim.
- Vëllezërit Ibishi nga fshati Dobërqan, Njoftim.
- Njoftim DMSH dhe Kryetarin për shtëpinë e Adnan Sahitit.
- Ballkan Auto Garage, vërtetim për Vërshime nga zyra me qytetar.
- Njoftim për Florim Mustafën për Vërshime nga zyra me qytetar.
- Njoftim për Moto Club Uglar për pjesëmarrje në garat që do të mbahen në f.sh Uglar të një njësie të Zjarrfikëseve.
- Njoftim për Kryetarin e Komunës, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtim, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Transport dhe Banim, Drejtoria e Inspeksionit, për uzurpime të lumenjve.
- Njoftim për Qemajl Xhaçkaj për lumin Stanishorka nga zyra me qytetar.
- Njoftim për Shaban Emini për shtëpinë e vjetër nga zyra me qytetar.
- Njoftim për Shemsedin Hasani për vërshime nga zyra me qytetar.
- Njoftimi për Këshillin e Banimit

Aktivitetet tjera ;

- Sipas vendimit me numër 1020 të datës 29.09.2022, për emërimin e Komisionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së II – të, për objektin e Naser Sadikut me numër të parcelës 05554-0. Gjatë shikimit të dokumentacionit teknik dhe kontrollin e bërë së bashku me anëtarët e komisionit në objektet e personit të lartcekur kemi konstatuar se;

- Sipas vendimit me numër 1020 të datës 29.09.2022 për emërimin e Komisionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së II – të, për objektin e Xhelal Rasim Demiri me numër të ndërtesës (njësia) 0-70403013-01761 – 15.

- Sipas vendimit me numër 1020 të datës 29.09.2022 për emërimin e Komisionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së II – të, për objektin e Shenasi Sadriu me numër të ndërtesës (njësia) 0-70403013-01592 – 2- me etazhitet B + P + 1 në katet Bodrumi 200 m², Përdhesa 209 m², kati i I parë 209 m².

## Raporti financiar për periudhën 01 janar -30qershor 2023

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Lënda : | Raporti i shpenzimeve për periudhen JANAR - QERSHOR 2023 i mjeteve nga fondet burimore : 10, 21, | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| Shpenzimet e mjeteve për Mallra dhe Shërbime, nga fondi burimor 10 , 21 , sipas kodeve ekonomike | | | | | | | | | | | |
| Nr. rend | Përshkrimi | Stafi | | Paga dhe meditje | Mallra dhe Shërbime | | Shpenz. Komunale | | Subvecione dhe Transfe | Shpenz. Kapitale | Totali |
| | | | | 11000 | 13000 | | 13200 | | | | |
| | Fondi Burimor | | | 10 | **10** | **21** | **10** | **21** | ** | ** | |
| | Mjetet e Planifikuara | | | **286,500.00** | **96,000.00** | **24,000.00** | **5,800.00** | **1,200.00** | ** | **100,000.00** | **513,500.00** |
| | Mjetet e Alokume | 43 | TM-I | 72,486.43 | ** | ** | ** | ** | | | 0.00 |
| | | | TM-2 | 75,416.10 | ** | ** | ** | ** | | | 0.00 |
| | | | TM-3 | | | | | | | | 0.00 |
| | | | TM-4 | | | | | | | | 0.00 |
| | Gjithsej të Shpenzuara | | | **147,902.53** | **57,007.02** | **5,489.80** | **3,108.92** | | | | **213,508.27** |
| | | | | | | | | | | | - |
| | Mjetet e mbetura | | | **138,597.47** | **38,992.98** | **29,489.80** | **2,691.08** | **1,200.00** | **** | **100,000.00** | **310,971.33** |
| Mjetet që nevojiten deri fund vitit pa ndryshime për paga | | | | | | | | | | | |
| Mos plotsimi i vendeve të punës, Mjete në suficit | | | | | | | | | | | |

## Intervenime nga NJPZH: janar -qershor 2023

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera

për periudhën kohore janar **Janar-Dhjetor 2023 Komuna Gjilanit**

| **Realizimi I daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera Janar-Dhjetor 2023** | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2023** | Nr.i përgj. i daljeve | Nr.i zjarreve | Nr. i Teknike | Nr.i shërbimeve | Aksidente rrugore | Vërshime | Të rejsh | Të lënduar | | | Të vdekur | | | Githsejt |
| | | | | | | | | zj. | qyt. | tot | zj. | qyt. | tot | |
| Janar | 33 | 19 | 9 | 0 | 2 | 3 | 0 | 0 | 3 | 3 | 0 | 0 | 0 | 33 |
| Shkurt | 44 | 39 | 2 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 44 |
| Mars | 34 | 30 | 3 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 34 |
| Prill | 29 | 13 | 7 | 3 | 1 | 5 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 29 |
| Maj | 23 | 14 | 4 | 3 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 23 |
| Qershor | 31 | 17 | 6 | 3 | 1 | 4 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 31 |
| Korrik | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Gusht | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Shtator | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Tetor | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Nëntor | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Dhjetor | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Gjithsejtë | | | | | | | | | | | | | | 194 |

**Siperfaqet e djegura në objektet ndertimore Janar- Dhjetor 2023**

**1. Ndarja analitike e zjarreve në : OBJEKTE NDËRTIMORE** — **GJITHSEJT**

| | LlOJI I INTERVENIMIT | Janar | | | shkurt | | | mars | | | prill | | | maj | | | qershor | | | korrik | | | gusht | | | shtator | | | tetor | | | nëntor | | | dhjetor | | | Sipërfaqet e djegura | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | tër | pje | pak |
| 1.1 | Banesa – shtëpi | | | 2 | | 1 | 2 | | 1 | | | 2 | | | | | | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 6 | 4 |
| 1.2 | Objekte ndimëse | | | | | 1 | | | | | | | | | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 3 | |
| 1.3 | Plevica - Shtalla | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1.4 | Objekte kolektive (banesa) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1.5 | Oxhaqe | | 4 | | | 8 | | | 6 | | | 1 | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 20 | |
| 1.6 | Të tjera | | | 1 | | 1 | | | | 1 | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1 | 3 |
| | **Gjithësejtë:** | 0 | 4 | 3 | 0 | 11 | 2 | 0 | 7 | 1 | 0 | 3 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 30 | 7 |

**2. Ndarja analitike e zjarreve në: OBJEKTE EKONOMIKE**

| | LlOJI I INTERVENIMIT | Janar | | | shkurt | | | mars | | | prill | | | maj | | | qershor | | | korrik | | | gusht | | | shtator | | | tetor | | | nëntor | | | dhjetor | | | Sipërfaqet e djegura | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | tër | pje | pak |
| 2.1 | Publike | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2.2 | Objekte Biznesi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2.3 | Objekte Indusiale | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1 | |
| 2.4 | Të tjera | | | | | | | | | | | | | | | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 2 |
| | **Gjithësejtë:** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 |

**3. Ndarja analitike e zjarreve në: PAISJE ELEKTRIKE**

| | LlOJI I INTERVENIMIT | Janar | | | shkurt | | | mars | | | prill | | | maj | | | qershor | | | korrik | | | gusht | | | shtator | | | tetor | | | nëntor | | | dhjetor | | | Sipërfaqet e djegura | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | të | pj | p | tër | pje | pak |
| 3.1 | Paisjet elektrike / tafo | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 0 | 2 | 0 |
| 3.2 | Paisjet shpërndarëse | | 3 | | | 1 | | | 1 | | | 3 | | | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 10 | |
| 3.3 | Gjenerator | | | | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1 | |
| 3.4 | Të tjera | | | 1 | | 3 | | | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 3 | 2 |
| | **Gjithësejtë:** | 0 | 4 | 1 | 0 | 4 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 16 | 2 |

**Pasqyra e zjarreve janar - dhjetor 2023**

| 2023 | Zjarrë në Objekte ndërtimore | | | | | | Zjarrë në Objekte ekonomike | | | | Zjarrë në Pajisje elektrike | | | | Zjarrë në Sipërfaqe të hapura | | | | Zjarrë në Autom. | Gjith. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Banesa / shtëpi | Objekte ndimse | Plevica - Shtalla | Objekte kolektive | Oxhaqe | Të tjea | Publike | Objekte Biznesi | Objekte Industriale | Të tjera | Pajisje elektrike | Paisjet shpërndarse | Gjeneratora | Të tjea | Mal | Bari i that | Sipërfaqe bujqsore | Të tjera | Automjete motorrike | |
| Janar | 2 | 0 | 0 | 0 | 4 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 3 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 4 | 3 | 19 |
| Shkurt | 3 | 1 | 0 | 0 | 8 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 3 | 9 | 10 | 0 | 2 | 1 | 39 |
| Mars | 1 | 1 | 0 | 0 | 6 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 9 | 3 | 0 | 6 | 2 | 30 |
| Prill | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 3 | 2 | 13 |
| Maj | 0 | 2 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 14 |
| Qershor | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 8 | 3 | 17 |
| Korrik | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gusht | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shtator | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Tetor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Nëntor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Dhjetor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjithsejtë | 10 | 4 | 0 | 0 | 20 | 6 | 0 | 0 | 1 | 2 | 2 | 10 | 1 | 5 | 20 | 14 | 0 | 27 | 11 | 132 |

**Raporti gjashtë mujor janar-qershor 2023, i inspektorëve të Parandalimit**

Në periudhën raportuese janë kryer inspektime të rregullta me ç 'rast janë hartuar procesverbale për zjarret e ndodhura nga të cilat njëzet e tre (23) prej tyre janë objekte banimi dhe publike ( 11 banimi dhe 3 publike), gjashtë (6) auto vetura dhe tre (3) zjarre fushore, gjithashtu janë lëshuar tre (3) vërtetime mbi zjarrin e ndodhur në objekte të ndryshme, kryesisht të sektorit privat, një (1) vërtetim mbi gjendjen e sigurisë nga zjarri, dy(2) njoftime për njësinë e hetuesisë së Policisë së Kosovës në Gjilan, kurse nëntë (9) pëlqime të dokumentacioneve teknike nga të cilat një (1) në sektorin publikut dhe shtatë (7) në sektorin privat në Komunën e Gjilanit.
Në vijim do ta keni pasqyrën tabelore të punëve të kryera gjatë periudhës në fjalë

| Komuna | | | Inspektimet | | | | | Sektori i Pasurisë | | | Numri i objekteve të inspektuara sipas kategorisë | | | | | | Nr.i aktvendimeve të marra | | | | Nr. i masave të verifikuara | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjilan | Partesh | Novobërdë | Themelore | Rregullt | Jashtëzakonshë | verifikues | Gjithsejtë | Shoqërorë | Privat | Gjithsejtë | I | II | III | IV | **Gjithsejtë** | Nr.i masave të propozuara | **Gjithsejtë** | Me procedurë të rregullt | Me procedurë të shkurtë | Numri i masave të urdhëruara | **Gjithsejtë** | Të kryera | Të pakryera | Në vazhdimësi | Nr.i masave që u ka skaduar afati | Nr.i masave që nuk u ka skaduar afati | Nr.i kërkesave për inicim të | Nr.i personave të përfshirë në | Nr.i raporteve mbi zjarrin | Nr.i pëelq.në dok.inv.teknik | Nr.i vend shikimeve të zjarrit |
| 1. | | | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
| 61 | 4 | 1 | - | 65 | - | - | 32 | 33 | 32 | 65 | 54 | 15 | - | - | 69 | 261 | - | 2 | - | - | - | - | - | 169 | - | 169 | | | 23 | 9 | 23 |
| **66** | | | **-** | **65** | **-** | **-** | **32** | **33** | **32** | **65** | **54** | **15** | **-** | **-** | **69** | **261** | **-** | **2** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **169** | **-** | **169** | **-** | **-** | **23** | **9** | **23** |

## Preventiva/Parandalimi

**Pasqyra tabelare e punëve të kryera për 6 mujorin e punës nga inspektorët e preventivës (01 janar – 30 qershor 2023)**

| Komuna Gjilan | Sektori i Pasurisë | | | **Aksident komunikacioni** | **Vërtetim zjarri** | **Vërtetim mbi e gjendjen nga sigurisë zjarri** | **Njoftime PK** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shoqërore | Private | Gjithsejtë | | | | |
| 1. | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 3 | 2 | 3 | 5 | - | 2 | - | 2 |
| **3** | **2** | **3** | **5** | **-** | **2** | **-** | **2** |

## 11. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar realizimin e aktiviteteve sipas Planit te Punës së Drejtorisë. DZHE vlerëson gjashtëmujorin e parë të këtij viti si mjaft pozitiv sa i përket realizimit të aktiviteteve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, lokal dhe mirëqenien e qytetarëve të komunës së Gjilanit.

Sa i përket investimeve kapitale, **janë gjithsej 18 projekte të reja infrastrukturë publike dhe sociale,** të cilat do të realizohen në bashkë-financim me Komunën e Gjilanit dhe me mbështetjen financiare nga niveli qendror (MAPL, MZHR, MMPHI) dhe donatorë (QATAR CHARITY, Islamic Relief Kosova, Advancing together etj) te cilat kapin **vlerën prej 6,829,104.29 (€).** Marrëveshjet për bashkëfinancim të gjitha këtyre projekteve janë nënshkruar ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe donatorëve gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti.

DZHE do të bashkë-financoj projektet me prioritet **në vlerën prej 3.157,383.80 (€)** nga të cilat **3,671,720.49** (€) do të financohen nga donatorët.

Drejtoria e vlerëson këtë periudhë si jashtëzakonisht të suksesshme sa i përket investimeve kapitale të cilat kontribuojnë direkt në zhvillim ekonomik lokal.

Aktualisht janë gjithsej 22 projekte, prej tyre 18 janë projekte të reja, ndërsa 4 janë projekte në realizim e sipër sipas marrëveshjeve nga viti paraprak derisa DZHE ka përgatit 6 projekte zhvillimore për aplikim ne MAPL, FKEE si dhe për konferencë të Donatorëve në Bruksel.

**Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të gjitha projektet e reja të cilat priten të realizohen gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024.**

| Nr. | Projekte të investimeve kapitale përmes kodit të bashkëfinacimit gjatë vitit 2023 | Donatori | Vlera e Projektit | Financimi nga Donatori | BF nga DZHE/Komuna |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Asfaltimi Rrugëve fsh. Gadish | MPHI | 100,000.00 | 100,000.00 | |
| 2 | Asfaltimi Rrugëve në Lagjen Vishnjet pjesa e dyte | MPHI | 108,410.00 | 67,764.00 | 40,646.00 |
| 3 | Asfaltimi Rrugës ne fsh.Kokaj-Gjilan | MPHI | 100,000.00 | 100,000.00 | |
| 4 | Asfaltimi Rrugëve në fsh. Malishevë e ulët Faza-2 | MPHI | 174,565.00 | 140,000.00 | 34,565.00 |
| 5 | Asfaltimi Rrugëve Jonuz Terstena-28 Nentori dhe Krahet 1-5 | MPHI | 308,100.00 | 250,000.00 | 58,100.00 |
| 6 | Asfaltimi Rrugëve "Qefsere Sadriu" dhe "Blerim Halil" | MPHI | 289,196.00 | 234,000.00 | 55,196.00 |
| 7 | Asfaltimi Rrugëve ne lagjen Livadhet e Arapi | MPHI | 301,580.00 | 250,000.00 | 51,580.00 |
| 8 | Asfaltimi Rrugëve ne F.sh. Burincë | MPHI | 345,685.00 | 280,000.00 | 65,685.00 |
| 9 | Rregullimi i Trotuaret dhe Ndriqimit /Haxhaj-Demiraj/ | MPHI | 179,000.00 | 143,200.00 | 35,800.00 |
| 10 | Proekti Kryesor per Rrugë - Nëna Terezë | MPHI | 512,625.00 | 410,000.00 | 102,625.00 |
| 11 | Parku Baja | MAPL | 249,989.50 | 87,500.00 | 162,489.50 |
| 12 | Ndërtimi I QMF | Qatar Charity | 320,000.00 | 176,000.00 | 144,000.00 |
| 13 | Përkrahja e familjeve me ujë të pijshëm në fshatrat : Bresalc, ponesh dhe Livoç ) | Islamic Releif | 156,521.74 | 79,826.09 | 76,695.65 |
| 14 | Memografi dhe laboratori | Islamic Releif | 157,846.40 | 93,430.40 | 64,416.00 |
| 15 | Kult Qendra | MZHR | 733,000.00 | 250,000.00 | 483,000.00 |
| 16 | Projekti renovimi I parkut ekzistues afer stadiumit ndihmes te futbollit | Advnacing Together | 42,591.88 | 10,000.00 | 32,591.88 |
| 17 | Asfaltimi I rrugës "Hamdi Kurteshi | MMPHI | 2,400,000.00 | 1,000,000.00 | 1,400,000.00 |
| 18 | Masat EE në Shfmu "Abaz Ajeti " | FKEE | 349,993.77 | | 349,993.77 |
| | | | | | |
| | | | **6,829,104.29** | **3,671,720.49** | **3,157,383.80** |

Disa prej projekteve të investimeve kapitale sipas Marrëveshjeve me donatorë janë planifikuar të realizohen për periudhën dy-vjeçare dhe priten të përfundojnë në vitin 2024 si në vijim projektet:

1.Kult Qendra
2.Zgjerimi dhe Asfaltimi i rrugës “Hamdi Kurteshi”

Ndërsa punimet që janë duke vazhduar për realizimin e 4 projekteve të bartura nga viti paraprak siç janë :

1. Asfaltimi i rrugës Livoç i ulët-Livoç i Epërm,
2. Asfaltimi i rrugës në fshatin Haxhaj,
3. Terrenet sportive
4. Kanalizimi fekal Livoç i Poshtëm-Livoç i Epërm-lagjja Kodra e Thatë.

| Nr. | Projekte te Investimeve kapitale (dy-vjecare) permes kodit te bashkefinancimit nga viti paraprak |
|---|---|
| 1 | Asfaltimi I rruges Livoq I Eperm-Livoq I Ulet |
| 2 | Asfaltimi RrugëvAsfaltimi i rrugës ne fshatin Haxhaj |
| 3 | Terrenet sportive |
| 4 | Kanalizimi fekal Livoq i poshtëm-Livoq i Eperm-lagjja Kodra e Thate. |

1. Gjatë kësaj periudhe të raportimit ka filluar realizimi i projektit “Parku Baja” dhe punimet janë duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë kohore.
2. Po ashtu gjatë kësaj periudhe ka filluar të realizohet edhe projekti “Rregullimi i Trotuareve dhe Ndriçimit në fshatin Haxhaj dhe Demiraj i cili është duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë kohore.
3. PROJEKTI - Renovimi i Parkut ekzistues afër stadiumit ndihmës të futbollit i bashkë financuar nga Komuna e Gjilanit (Drejtoria për Zhvillim Ekonomik) në bashkëfinancim me OJQ "Adancing Together projekt ky i cili është në fazën përfundimtare.

DZHE ka përgatit projekt propozimin për thirrjen e MAPL Programi “ Mbështetje për komuna për projekte për infrastrukturës socio-ekonomike” dhe ka dorëzuar projektin me titull “Krijimi i xhepave të gjelbër në hapësirat urbane në Komunën e Gjilanit” me datën 12.05.2023.

Ky projekt parasheh regjenerimin e një pjese urbane të qytetit përmes rregullimit të një parku të ri, krijimin e xhepave te gjelbër, dhe vende të posaçme për hedhjen e mbeturinave në hapësira publike në pronësi të Komunës së Gjilanit me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit.
Zona ku synohet të transformohet në zonë të urbanizuar duke krijuar një ambient modern për rekreacion, pushim dhe aktivitete të ndryshme për fëmijë dhe të rritur.
Përmes investimit me këtë projekt synojmë edhe promovimin për ruajtjen e ambientit, krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta publike me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik të Komunës. Projekti i propozuar ka buxhetin prej 100,000.00 €, shumë kjo e cila është kërkuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Gjatë muajit qershor 2023, DZHE ka përgatitit tri (3) projekt koncepte (shih tabelën më poshtë) për t'u prezantuar në Konferencën e Donatorëve në Bruksel, e cila pritet të organizohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë këtij viti. Vlera e projekteve kap shumen prej 26, 436, 625.00 Euro.

| Nr | Titulli i projektit | Vlera € |
|---|---|---|
| 1 | Zona Ekonomike në Gjilan | 24,575,890.00 |
| 2 | Efiqienca e Energjisë se Ndriçimit Publik | 1,860,735.00 |
| 3 | Penda e Livoçit | 6,911,868 .60 |
| **Gjithsej** | | **26,436,625.00** |

Të gjitha këto projekt koncepte janë projekte strategjike dhe prioritare të Komunës së Gjilanit me ndikim në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal dhe rajonal.

**Fondi për Ndërmarrësit e rijnë**

DZHE ka filluar përgatitjet me qëllim të lansimit për herë të parë të "Fondit për Ndërmarrësit e rinj" për subvencionim të bizneseve ekzistuese përfshirë ato të grave ndërmarrëse dhe biznese të reja start-up e cila pritet të publikohet në 3 mujorin e dytë të këtij viti.
Për këtë fond janë alokuar 135,000 €uro buxhet dhe deri më tani është duke u finalizuar metodologjia (Udhëzuesi për aplikant, Forma e Aplikacionit, Buxheti, Projeksionet etj) për Thirrjen "Fondi për Ndërmarrësit e rijnë" për subvencionim të bizneseve me prioritet bizneset e grave ndërmarrëse dhe të rinjtë nga Komuna e Gjilanit.

Ky fond ka për qëllim të ofrojë mbështetje zhvillimit te bizneseve si dhe përmirësimin e klimës të të bërit biznes përmes krijimit të mundësive më të mira për qasje në financa për bizneset të cilat kanë plane për zgjerim të afarizmit dhe ngritje të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.
DZHE mbetet e përkushtuar të mbështes promovimin dhe zhvillimin e sektorit privat si dhe krijimin e vendeve të reja te punës.

## SEKTORI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË

Një tjetër sektor tejet i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe Efiçienca e Energjisë.
Gjatë kësaj periudhë të raportimit është përfunduar projekti për intervenim me masa të EE në shkollat "Mehmet Isai" dhe "Rexhep Elmazi" të financuara nga FKEE. Të gjitha punimet janë përfunduara me sukses si dhe është bërë inaugurimi i tyre.

Gjatë kësaj periudhe 6 mujore është nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe FKEE, për intervenim me masa të EE në Shfmu "Abaz Ajeti". Punimet e këtij projekti kanë filluar sipas planit dinamik në SH.F.M.U. "Abaz Ajeti" projekt i investimeve me masa efiçiente të energjisë. Sipas kontratës Operatori Ekonomik në bazë të afatit kohor për përfundimin e punëve për projektin në SH.F.M.U. "Abaz Ajeti " do të jetë deri më 31 gusht 2023. Ky projekt i investime me masa efiçente të energjisë në SH.F.M.U. "Abaz Ajeti " Komunës së Gjilanit do t'i kushtojë rreth 349,993.77 €.

DZHE gjatë kësaj periudhe ka përgatitur projekt propozimin për aplikim në thirrjen publike nga FKEE "Projekti Emergjent për Masat e Efiçençës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore (sociale) në Pronësi të Komunës së Gjilanit.
Pas vlerësimit nga komisioni vlerësues i FKEE dy objektet e banimit social janë përzgjedhur për financim nga Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë ku është dërguar njoftimi me datën 16.05.2023 ku në këto 2 objekte të banimit social do të intervenohet me masa efiçiente pasi të nënshkruhet marrëveshja finale për Komunën e Gjilanit në muajt në vijim.

Drejtoria ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Ekonomisë dhe KFW (Banka Gjermane), për fillimin e zbatimit të masave të EE në objektet publike respektivisht për dy Shkollat Fillore: Shkollën Fillore të Mesme dhe Ulët "Liria" në fshatin dhe Pogragjë dhe Shkollën Fillore të Mesme dhe Ulët "Ibrahim Uruqi" në fshatin Bresalc.

Këto dy projekte menaxhohen nga Ministra e Ekonomisë, ndërsa Komuna e Gjilanit si përfituese ka ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim të fillimit të ekzekutimit të punimeve.

Sipas Ministrisë, marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Operatorit Ekonomik dhe Komunës së Gjilanit pritet të nënshkruhet së shpejti.

Projektet e lartpërmendura në fushën e Efiçencës së Energjisë synojnë intervenimin me masa të efiçiencës së energjisë në objektet publike, duke mundësuar kursimin e konsiderueshëm të energjisë dhe realizimi i të cilave do të ndikojë në krijimin e vendeve të punës në sektorin e ndërtimtarisë.

Në këtë periudhë është finalizuar draft dokumenti i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë ( PKVEK) për Komunën e Gjilanit në bashkëpunim me GIZ dhe grupin punues komunal.
Me 20.06.2023, drejtoria ka bashkëpunuar ngushtë edhe me kolegjiumin për energji, Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe Fondit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë (FKEE) ku është prezantuar nga FKKE Programi i "Masave për Efiçiencë të Energjisë për shtëpi individuale në sektorin rezidencial ku edhe Komuna e Gjilanit do të aplikojë këtë program për shtëpitë individuale.

**AKTIVITET E REALIZUARA**

Gjatë periudhës 6 mujore të vitit 2023, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka realizuar aktivitete të ndryshme dhe vizita përfshirë organizimin dhe pjesëmarrjen në punëtori ndryshme të organizuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare siç janë ” Instituti për Qeverisje Lokale”, ”Departamenti i ndihmës Shtetërore “, UNIONI I TURIZMIT TË KOSOVËS”, Asociacioni i Komunave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës” ,“USAID,“OJQ të ndryshme ” Ministria e industrisë, ndërmarrësisë dhe tregtisë (MINT), Ministria e administrimit dhe pushtetit lokal (MAPL) ,”CARITAS” si dhe vizita të ndërmarrjeve publike komunale dhe vizita bizneseve lokale. DZHE ka qenë pjesë e trajnimeve të organizuara nga organizata të ndryshme vendore dhe të huaja të cilat kanë për qëllim trajnimin e zyrtarëve komunal në fusha të ndryshme.

| Data | Emri i trajnimit | Qëllimi i trajnimit |
|---|---|---|
| 03 maj dhe 04 maj | **“Trajnimi për Projekte Investuese”**<br><br>Organizuar :nga Caritas dhe Germin | Qëllimi i trajnimit ka qenë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal në planifikimin, hartimin, përpilimin dhe zhvillimin e koncept projekteve të cilat kanë të bëjnë me investimet socio-ekonomike dhe kapitale. |
| 31 Maj dhe 01 dhe 02 Qershor | **Hartimi dhe meanxhimi i projekte Investuese”**<br><br>Organizuar :nga Caritas dhe Germin | Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë në hartimin e projekteve investuese dhe përpilimin e ndonjë një projekti të komunës. |
| 22 dhe 23 qershor | **Komunat e Mençura dhe promovimi i tyre**<br><br>Organizuar :nga Asociacioni i komunave | Qëllim i këtij trjanimi ka qenë të trajtoj aspekte të ndyshme që ndërlidhen me digjitalizimit të zonave turistike në komuna, si të trajtohet ky proces, cfarë roli duhet të kenë komunat në këtë proces, rëndësia e bashkëpunimit me bizneset |
| 27.06.2023 | **“Bashkëpunimi Ndërkomunal”**<br><br>Organizuar :nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale | Qëllimi i këtij trajnimi është diskutimi dhe trajtimi i mundësive të bashkëpunimit ndërkomunal që ua ofron komunave në realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale. |

Gjatë kësaj periudhe 6 mujore, drejtoria ka përkrahur dhe asistuar bizneset start up dhe ato ekzistuese të Komunës së Gjilanit në thirrjet për grante nga USAID-CDF, Ministria e Zhvillimit Rajonal PZHRB 2023 (grante për biznese) dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me ç 'rast nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik janë përkrahur gjithsej rreth 120 biznese të Komunës së Gjilanit përmes këshill dhënies si dhe informata rreth procesit dhe procedurave të aplikimit.
Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore janë realizuar rreth 55 vizita në terren bizneseve, ndërmarrjeve publike, projekteve në realizim e sipër me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të ndryshme të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të Drejtorisë.

| **Data e thirrjes** | **Emri i thirrjes së grantit** | **Afati i mbylljes** |
|---|---|---|
| 09.06.2023 | Thirje publike për subvencionim me mjete financiare për ndërmarjete vogla dhe të mesme<br><br>Thirrje nga Ministria e Industrisë,Ndërmarësisë dhe Tregtisë<br><br>Grantet janë ndarë në tri kategori:<br><br>**Lot 1-Ndërmarjet mikro të punësuar deri në 9 puntor**<br><br>**Vlera aplikimit:20,000 €**<br><br>**Lot 2-Ndërmarjet e vogla të punësuar nga 10 puntorë deri 49 puntorë**<br><br>**Vlera aplikimit:35,000 €**<br><br>**Lot 3-Ndërmarjet e mesme të punësuar nga 50 puntorë deri 249 puntorë**<br><br>**Vlera aplikimit:50,000 €**<br><br>Shuma e përgjithshme e kësaj thirrje është rreth **1,000.000.00 €** | **29.06.2023** |

Gjithashtu, janë mbajtur rreth 182 takime me palë të interesuara me c'rast janë dhënë këshilla dhe udhëzime sipas kërkesave dhe nevojave të tyre në fushën e zhvillimit ekonomik.

## QENDRA PER REGJISTRIMIN E BIZNESEVE

Në Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve gjatë kësaj periudhe 6 mujore janë të regjistruar 294 biznese të reja dhe të punësuar rreth 507 punëtorë ndërsa janë shuar 50 biznese.

**RAPORTI 01.01.2023 -30.06.2023**

| | Të regjistruara 2023 | | | | | | Të regjistruara 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emertimet | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Raporti 6mujor |
| Prodhuese | 10 | 7 | 4 | 4 | 4 | 7 | 36 |
| Tregtare | 11 | 12 | 13 | 8 | 17 | 10 | 71 |
| Shërbyese | 19 | 38 | 32 | 22 | 28 | 31 | 170 |
| Ndërtimore | 1 | 2 | 7 | 1 | 4 | 2 | 17 |
| Gjithësej: | 41 | 59 | 56 | 35 | 53 | 50 | 294 |
| Pronare femra | 6 | 11 | 13 | 5 | 12 | 12 | 59 |
| Pronar meshkuj | 35 | 48 | 43 | 30 | 41 | 38 | 235 |
| Numri I punëtorve | 64 | 111 | 105 | 60 | 83 | 84 | 507 |
| Emertimet | Të ç'regjistruara 2023 | | | | | | Të ç'regjistruara 2023 |
| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | |
| Prodhuese | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 2 | 6 |
| Tregtare | 1 | 3 | 0 | 2 | 2 | 1 | 9 |
| Shërbyese | 7 | 4 | 4 | 11 | 4 | 3 | 33 |
| Ndërtimore | | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 2 |
| Gjithësej: | 9 | 7 | 5 | 15 | 8 | 6 | 50 |
| Pronar meshkuj | 5 | 7 | 4 | 12 | 6 | 5 | 39 |
| Pronare femra | 4 | 0 | 1 | 3 | 2 | 1 | 11 |
| Numri I punëtorve | 13 | 12 | 6 | 18 | 11 | 7 | 67 |

Sa i përket raportit të Qendrës për regjistrimin e bizneseve krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të numrit të bizneseve, numrit të puntorëve dhe më pak shuarje të bizneseve në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, duke krahasuar me vitin 2022 që do të thotë ka një trend pozitiv.

## ZONA EKONOMIKE

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka ofruar informata dhe të dhëna me qëllim të përgatitjes së studimit të fizibilitetit për zonën ekonomike. Gjithashtu, Komuna ka shpall njoftimin për dëgjim publik ku pritet që komuniteti i biznesit dhe ekspertët të ofrojnë propozime, komente dhe sygjerime në draft Studimin e Fizibilitetit me qëllim që dokumenti të jetë sa më kualitativ dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal.
Dëgjimi publik është mbajtur me 11.05.2023 me ç'rast ekspertët e Universitetit te UBT-se kanë prezantuar studimin e fizibilitetit në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit si dhe janë marrë propozime dhe rekomandime nga ana e pjesmarrësve, kryesisht përfaqësuesve të komunitetit të biznesit në lidhje me dokumentin.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka bashkëpunuar ngusht me NPL "Tregu", NPL "Stacioni i Autobusëve" dhe PPP "Eco-higjiena" me qëllim të kordinimit të veprimeve me kompanitë publike për të rritur efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Gjilanit.
Vlen të përmendet së Komuna e Gjilanit ka ndarë buxhet në vlerë prej 116,000 Euro për subvencionim të NPL "Tregu" me qëllim të sigurimit të mekanizmit për mirëmbajtje të hapësirave publike si dhe mbështetje në qëndrueshmërinë financiare të kësaj ndërmarrje.

Drejtoria do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë dhe është në kërkim të partneriteteve me të gjithë akterët relevant në nivel lokal dhe qendror, donatorë, shoqëri civile, komunitet të biznesit, me qëllim të koordinimit të iniciativave dhe aktiviteteve të cilat ndikojnë në rigjenerimin ekonomik, rritjen ekonomike si dhe përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetesës së qytetarëve.

### Raporti financiarë i drejtorisë për zhvillim ekonomik

Në tabelën e mëposhtme gjeni Raportin e Planifikimit Fillestar vjetor të vitit 2023 janar-dhjetor dhe shpenzimet e Drejtorisë të periudhës janar-qershor 2023.

Realizimi i shpenzimeve financiare me përqindje për periudhën 6 mujore 2023 është 50.51 % sipas planifikimit të shpenzimeve.

## RAPORT I SHPENZIMEVE / Janar-Qershor 2023

## Planifikimi Fillestar - 2023

| Drejtoritë/Programet | Drejtoritë/ Programet | Numri i puntoreve | Pagat | Mallra dhe sherbime | Shpenzime komunale | Subvencione | Shpenzime kapitale | Rezervat sipas Ligjit buxhetit | Gjithësejt € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zhvillim Ekonomik | 480/48027 | | 88,999.99 | 130,000.00 | 2,000.00 | 264,332.79 | 2,002,745.50 | - | 2,488,078.28 |
| **Gjithësejt €** | | | **88,999.99** | **130,000.00** | **2,000.00** | **264,332.79** | **2,002,745.50** | **-** | **2,488,078.28** |

## Shpenzimet - 2023

| Drejtoritë/Programet | Drejtoritë/ Programet | Numri i puntoreve | Pagat | Mallra dhe sherbime | Shpenzime komunale | Subvencione | Shpenzime kapitale | Rezervat sipas Ligjit buxhetit | Gjithësejt € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Zhvillim Ekonomik** | **480/48027** | | **46,009.78** | **39,818.70** | **403.20** | **50,000.00** | **374,607.68** | | **510,839.36** |
| **Shpenzimet Shprehur në %** | | | **51.70** | **30.63** | **20.16** | **18.92** | **18.70** | | |
| Vetem te Zotuara | | | - | 4,329.34 | - | - | 636,942.56 | | |
| Shpenzimi + Zotimi | | | 46,009.78 | 44,148.04 | 403.20 | 50,000.00 | 1,011,550.24 | - | 510,839.36 |
| Shpenzimet + Zotimet Shprehur ne % | | | 51.70 | 33.96 | 20.16 | 18.92 | 50.51 | | |

## 12. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

**Kultura**

- 34 Aktivitete Kulturore
- 45 Shfaqje në Teatrin e Qytetit
- 6774 artikuj të ndryshëm të përpunuar dhe inventarizuar në katalog të ekzemplarëve në Bibliotekën e qytetit
- Galeria e qytetit ka pasur aktivitete për 6 muaj rresht, me ekspozita nga artistë vendorë e të jashtëm, të cilat janë përcjellë me shumë botime dhe punime artistike (5 ekspozita)

**Sporti**

- Stadiumi Ndihmës gjatë 6 mujorshit të parë ka pasur 50 ndeshje
- Palestra "Bashkim Selishta" - 91 Ndeshje zyrtare
- Stadiumi i Qytetit ka pasur - 6 Lojë

**Rinia**

- Shtëpia e Rinisë, ka pasur një sërë aktivitetesh, duke përfshirë edhe trajnime profesionale. Beetroot Academy në bashkëpunim me DKRS Gjilan, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ku për qëllim janë aftësim i të rinjve të shkollave të mesme dhe fakulteteve në fushën e IT, ku trajnimet mbahen në Shtëpinë e Rinisë

**Subvencionet: Dallimi në vite**

**2021**

- Mbi 40.000€ janë te ndara por pa thirrje publike

**2022**

- Sport 120.000€, (këtu kemi rritje 100%)
- 25.000€ të ndara për Klubin e Volejbollit Drita Femra, 10.000€ Klubit te Meshkujve Drita.
- 25.000€ Rini,
- 70.000€ Kulture

**2023**

- 200.000€ Kulture (100.000€ ose 43% rritje prej vitit 2022)

- Rini (50.000€ ose 50% rritje prej vitit 2022)
- Sport 120.000 sa vitin 2022 + ndarjet me Kuvend 84.445.16€,
- (30.000€ Klubit Volejbollit Drita te Femrave,
- Rreth 6000€ Klubit te Boksit Drita dhe
- Klubit te Volejbollit Drita te Meshkujve 10.000€)

**Projektet:**

**1.** MoU me MKRS per 8 xhepa të gjelbër - 690.000.00€ (Shillove, Demiraj, Livoç i Epërm, Bresalc, Miresh, Përlepnicë, Lagjja Iliria, Shkolla Nazmi Hoxha)
**2.** MoU me MKRS - Hartimi i Master Planit - Kompleksit Sportiv të Palestrës Sportive "Bashkim Selishta" - 820.000.00€
**3.** Mou me MKRS –Flaka e Janarit 30.000€ dhe Festivali i Teatrove të Shkollave të Mesme në vlerë prej 10,000.00€
**4.** MoU me MKRS, Skulpturat Monumentale ( "Heroina e Qytetit" – 26.000€, "Drama Shqiptare" 44,700.00€)
**5.** Thirrja Publike nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për Skulpturat "Heroi Kadri Zeka" – 80.000€, dhe Tribunin "Ramiz Cërnica" – 80.000€

**Biblioteka**

Gjatë muajit Qershor në Bibliotekën tonë janë përpunuar dhe inventarizuar në katalog - 1556 ekzemplarë të librave.

- Të inventarizuara -75
- Të përpunuara 112 prej tyre 15 autorë dhe 35 katalogje
- Në bibliotekë gjatë muajit Qershor, lexues aktivë janë – 202 anëtarë të rinj;
- Këta lexues në bibliotekës kanë huazuar -1875 libra dhe
- 1138 revista e 81 gazeta dhe materiale të periodikut.
- Që nga fillimi i muajit qershor në sallat e bibliotekës janë bërë 3401 shërbime.
- Gjatë muajit qershor përmes katalogut online të bibliotekës, lexuesit kanë shfletuar mbi 950 herë revistat dhe artikujt shkencor të katalogut.

- përmes përdorimit të programit elektronik është lehtësuar puna dhe janë duke u përdorë edhe modulet e pasurimit, huazimit dhe të gjitha të dhënat e punës nga katalogu nga data në datë janë të siguruara në serverin e shënimeve, që nga fillimi i këtij muaji studentët do të mund ti gjejnë dhe përdorin edhe serialet dhe artikujt tjerë shkencorë.

**Shtëpia e Rinisë**

Sektori i rinisë gjatë muajit Qershor, ka patur bashkëpunim me OJQ-te rinore të cilat kanë për qëllim fuqizimin e rinisë si brenda komunës së Gjilanit po ashtu edhe me OJQ-të partnere nga Prishtina.

1. Më 12 Qershor, Zëri Rinor filloi punëtorinë "Pse Vullnetarët", me grupmoshat 15-24 vjeç, ku për qëllim është ngritja e vullnetarizmit rinor në komunën e Gjilanit. Ky projekt financohet nga DKRS Gjilan.

2. Fuqia e Bashkimit Rinor në kuadër të aktiviteteve rinore ka organizuar turnir në Volejboll me të rinjtë e shkollës Abaz Ajeti.

3. Fuqia e Bashkimit Rinor, në kuadër të aktiviteteve rinore për datën 1 Qershor, ka mbajtur aktivitet në Qendrën e Down Syndrome Kosova në Gjilan. Ky aktivitet është në vazhdën e bashkëpunimeve në mesë DKRS dhe Ojq rinore të komunës së Gjilanit.

4. D&D Business Support Center ka mbajtur trajnim 5 ditor në komunën e Gjilanit me temë "Trajnim në Ndërmarrësi dhe Vetëpunësim", ku si target kanë qenë të rejat e komunës së gjilanit në mesin e 150 pjesëmarrësve nga e gjithë Kosova.

5. Beetroot Academy në bashkëpunim me DKRS Gjilan, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ku për qëllim janë aftësim i të rinjve të shkollave të mesme dhe fakulteteve në fushën e IT.

## NJËSIA E KUVENDIT

Bazuar në Planin e punës së Njësisë së Kuvendit dhe Planin e punës të Kuvendit për periudhën janar-qershor 2023, Njësia e Kuvendit ka kryer këto aktivitete:

- Përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të rregullta, të jashtëzakonshme dhe urgjente të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, bazuar në Orarin vjetor për mbajtjen e seancave të KK-Gjilan,
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në Kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve,
- Përcjellja e takimeve dhe mbajtja e procesverbaleve të KK-së dhe Komisioneve tjera të formuara nga KK-ja,
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Zyrës së Kryetarit dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi simultan i seancave të rregullta dhe të tjera të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale,
- Dërgimi në MAPL i raportit mujor, për të gjitha aktet dhe shkresat e përkthyera të lëshuara nga Institucionet komunale,

- Lekturimi i të gjitha materialeve të Kuvendit dhe Komiteteve, dhe materialeve e akteve tjera të KK-së,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha materialeve për seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale, në formë fizike dhe elektronike,
- Përgatitja teknike e Sallës së Kuvendit, kujdesi për mirëmbajtjen e aparaturës për zërim dhe incizimi përmes kamerës dhe incizimi tonik i seancave.
- Njoftimi me kohë i anëtarëve të Kuvendit për mbajtjen e seancave të KK-së,
- Dërgimi i të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,
- Dërgimin e raporteve të rregullta mujore në MAPL për të gjitha aktet e miratuara nga KK-Gjilan,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha vendimeve, rregulloreve, rekomandimeve e akteve tjera brenda institucioneve komunale, me qëllim të implementimit të tyre.,
- Bashkëpunimit brenda institucioneve komunale dhe me organet qeveritare, dhe ministritë tjera të linjës, në funksion të mbarëvajtjes së funksionimit sa më të mirë të organeve komunale.

Gjatë periudhës janar-qershor 2023, Kuvendi dhe Komitetet e KK-së kanë mbajtur takimet si në vijim:

- Kuvendi ka mbajtur 4 seanca të rregullta dy seanca solemne dhe tri të jashtëzakonshme. Kuvendi i Komunës në katër takime të rregullta të mbajtura deri në muajin qershor 2023, ka miratuar 54 vendime dhe dy Rekomandime në mesin e tyre edhe Programin tre vjeçar të Banimit 2023/2025 si dhe Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Nagip Rexhepi". Po ashtu gjatë kësaj periudhe KK, ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2022 si dhe Raportin vjetor për vitin 2022 të kryetarit të Komunës.
- Komiteti obligative, ai për Politikë dhe Financa ka mbajtur 5 mbledhje dhe ka nxjerrë 56 Rekomandime për Kuvend dhe, Komiteti për Komunitete gjithashtu ka mbajtur 6 mbledhje dhe ka nxjerrë një Rekomandim për Kuvend.
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Agrikulturë ka mbajtur një takim dhe ka nxjerrë një rekomandim
- Komiteti Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara ka mbajtur një takim dhe ka nxjerr një Rekomandim
- Komiteti për Shëndetësi dhe MS ka mbajtur dy takime dhe ka nxjerrë dy Rekomandime për Kuvend
- Komiteti për Planifikim Urban dhe MM, ka mbajtur dy takime dhe ka nxjerrë një Rekomandim
- Komiteti për Shërbime Publike, ka mbajtur një takim dhe ka nxjerrë një Rekomandim
- Komiteti për Arsim, ka mbajtur katër takime dhe ka nxjerrë 4 Rekomandime
- Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport ka mbajtur katër takime dhe ka nxjerrë pesë Rekomandime
- Komiteti për Barazi Gjinore ka mbajtur një takim
- Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitarë, ka mbajtur tri takime dhe ka nxjerrë një Rekomandim
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur tri takime dhe ka nxjerrë një Rekomandim

Njësia e Kuvendit gjatë periudhës janar-qershor 2023, nga bashkëpunimi që ka pasur me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të akteve të dërguara, nuk ka pranuar asnjë akt për rishqyrtim në Kuvend.

## Njësia e Personelit

Raporti i punës përfshin përmbledhjen e aktiviteteve punuese në Njësinë e personelit për periudhën janar – qershor 2023
Njësia e personelit merret kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore të cilët janë pasuria kryesore e një organizate buxhetore. Menaxhimi i burimeve njerëzore është proces i cili tejkalon kufijtë e njësive buxhetore dhe përbëhet nga disa komponentë edhe atë: Planifikimi, punësimi, menaxhimi i performancës, trajnimi dhe zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë.
Po ashtu Njësia e personelit bënë mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, kryesisht nga marrëdhënia e punës dhe procedura administrative, duke bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet e saj me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë përkatëse lidhur me zbatimin e përgjegjësive të Komunës të cilat rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore nga sfera e marrëdhënies së punës dhe pagave të SHC.
Andaj, Njësia e personelit në kuadër të planit të saj punues, këtë vit ka kryer aktivitetet punuese si në vijim:
Akt emërime 4, Kontrata në vepër dhe kontrata tjera 84, ka shpallur 5 konkurse për 9 pozita me gjithsej 67 dokumente, hartimit i 60 vendime të ndryshme, 8 takime pune, 28 vërtetime të ndryshme, 26 pushime mjekësore, pushime vjetore 70, 5 pushime të tjera, ka hartuar shkresa 15, njoftime 19, përgjigje 8, kërkesa të ndryshme 9, përshkrimi i pozitave punuese për nevoja të drejtorive 13, plotësimi i formularëve për MAP 144, 84 konsultime me zyrtarë dhe të tjera, aktivitete të ndryshme 12, janë përpunuar, skanuar dhe regjistruar në SIMBNJ 3 dosje, janë skanuar dhe kopjuar 89 dokumente, si dhe 28 shërbime dhe këshilla të ndryshme.

**<u>Aktivitetet shtesë:</u>**

- Mbajtja e përhershme e evidencës së punëtoreve të Komunës përmes sistemit elektronik;
- Menaxhimi me lista të pagave së Shërbyesve civilë;
- Menaxhimi me stafin në aspektin e mbajtjes së trajnimeve të ndryshme;
- Raportimi nivelit qendror; MAPL dhe MAP për numrin e punëtoreve sipas gjinisë, kualifikimit, etnitetit etj;
- Përgatitja e formularëve: për punëtorë të ri, ndryshime, të larguar, retroaktive dhe dërgimi i tyre në Ministrinë e Administratës Publike - Divizioni i pagesave, Prishtinë;
- Ofrimi i të dhënave për auditorin e brendshëm, jashtëm dhe KPMSHCK;
- Përpunimi dhe azhurimi i listës së SHCK;
- Bashkëpunimi me të gjithë drejtoritë komunale sa i përket aspektit të nëpunësit civil;
- Përgatitja e konkurseve, publikimi i tyre dhe zhvillimi i procedurave rekrutuese konform konkurseve;
- Shfrytëzimi i pushimeve vjetore, mjekësore, vdekjes, lehonisë, etj. përmes SIMBNJ

- Përpunimi i dosjeve të nëpunësve civil dhe futja e dosjeve në SIMBNJ
- Pjesëmarrja në trajnime rreth SIMBNJ, monitorimit të performancës, etj

## NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Gjatë këtyre muajve kemi monitoruar përputhshmërinë dhe respektimin e standardeve për të drejtat e njeriut në këto fusha: mundësi të barabarta, mbrojtje nga diskriminimi, barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me nevoja të veçanta, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore e tjera.

Si zyrë e NJDNJ, keni monitoruar seancat e Kuvendit, Komiteteve, KKSB-në dhe takime të tjera të organizuara në kuadër të komunës.

Kemi mbajtur takim të organizuar nga MAPL dhe Demos, ku kemi diskutuar për vlerësimin e kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të punuar me grupet e margjinalizuara.

Gjithashtu, kemi organizuar takim pune me OJQ "Gruaja Hyjnore" me ç 'rast kemi diskutuar për të drejtat e punës për të gjithë pa dallim.

Përpos takimit që kemi mbajtur me zyrtarët e Zyrës për Preshevë dhe Bujanoc, po ashtu kemi marrë pjesë në tryezën e organizuar nga Zyra e Kryetarit, për nderë të ditës së të dëbuarve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, që janë të vendosur në Gjilan.
Në cilësi të Zyrtarit për Konsultime Publike, kemi organizuar të gjitha konsultimet publike për kornizën buxhetore 2024-2026, si dhe kemi publikuar njoftimet për konsultime publike në faqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës – Zyra për qeverisje të mirë.

Zyra për Barazi Gjinore në gjashtëmujorin e parë të vitit ka përgatitur Planin Vjetor të Punës për Barazi Gjinore për vitin 2023, në përputhje me rekomandimet e nxjerra nga Komuna, Agjencia për Barazi Gjinore, Ministria e Financave në harmoni me vendimet e qeverisë.

ZBGJ në muajin janar u sugjeroi drejtorëve komunal, që planet e tyre të punës për vitin 2023 t'i hartojnë nga perspektiva gjinore, politikë kjo që do të ndikoj në eliminimin e pabarazive gjinore në çdo sektor, me fokus në sektorin e arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, kulturës, rinisë dhe sportit, bujqësisë, menaxhimit të financave, menaxhimit të burimeve njerëzore e informimit publik, duke e ditë se integrimi gjinor në politikat publike komunale është obligim ligjor, pasi është e përcaktuar edhe me Ligjin për Barazi Gjinore dhe dokumentet tjera strategjike sektoriale të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, siç është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, nga i cili dokument dalin një sërë obligimesh për avancimin e barazisë gjinore.

Gjatë muajit janar zyra për barazi gjinore në bashkëpunim me Strehimoren "Liria" organizuan trajnimin për Mekanizmin Komunal Kundër Dhunës në Familje për **"Protokollin e Shtetit për Trajtimin e Rasteve te Dhunës Seksuale**" protokoll i cili është lansuar me 5 dhjetor 2022 nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Zyra për barazi gjinore gjatë periudhës 3 mujore ka marr pjesë në disa punëtori e trajnime të organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike me temë **"Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës".**

Agjencia për Barazi Gjinore organizoi punëtorinë për harmonizimin e Planeve të Punës së ZBGJ me planin e ABGJ-së, si dhe me aktivitetet e parapare në PKBGJ.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), organizoi punëtorinë me grupin e parë të anëtarëve të ekipit për drejtat e fëmijës me 12 komuna të cilat i kanë themeluar EDF-të, sipas Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022, për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, i cili ekip do të punojë në përgatitjen e planit të punës për të drejtat e fëmijëve në harmoni me legjislacionin vendor.
Në kuadër të javës së gruas ZBGJ i Rekomandoi Drejtorisë së Arsimit realizimin e aktivitetit: që në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Gjilanit, një orë mësimore t'i kushtohet shënimit të **"8 Marsit- Dita Ndërkombëtare e Gruas"**, me qëllim të sensibilizimit të nxënësve për barazinë gjinore në përgjithësi dhe rolin e veçantë të gruas që ka në shoqëri.

Për nderë të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, u inaugurua monumenti **"Heroina e Qytetit"** në respekt të kontributit të jashtëzakonshëm të nënave, grave dhe vajzave, në të gjitha kohërat dhe fushat e jetës. Në këtë ditë të veçantë, ministrja e drejtësisë, kryetari i komunës, nënkryetarja dhe kryesuesi i kuvendit ndanë mirënjohje për gratë veprimtare të Komunës së Gjilanit, 3 nga to post mortum dhe 2 mirënjohje për gratë që ende kontribuojnë në ngritjen dhe avancimin e pozitës së gruas në shoqëri.
Në vazhdën e aktiviteteve në kuadër të "Javës së Gruas" u organizua takimi me gratë e moshës së tretë nga OJQ "Gruaja Hyjnore" në bashkëpunim me zyrën e barazisë gjinore, OSCE, Aktivin e Grave pensioniste dhe QPS e cila u mbështetë edhe nga Zyra e Kryetarit, me qëllim që kërkesat e grave të kësaj moshe të adresohen për një jetë më të dinjitetshme.

Gjatë periudhës 6 mujore ZBGJ organizoi 2 takime të Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, ku u informuam rreth rasteve të dhunës në familje të raportuara për periudhën gjashtë mujore. U vlerësua se situata e dhunës në familje është pothuajse e njëjtë në krahasim me vitin paraprak, në bazë të rasteve të paraqitura në institucionet përgjegjëse.

Në cilësinë e anëtares së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ZBGJ mori pjesë në 3 takime të organizuar në muajin shkurt, prill dhe qershor ku kontribuoi në ngritjen dhe diskutimin e çështjeve të sigurisë së qytetarëve në përgjithësi dhe për sigurinë e vajzave dhe grave si grup i margjinalizuar në veçanti.

U shënua 15 Maji-Dita Ndërkombëtare e Familjes me aktivitet simbolik, me pankarta në duar të cilat përcillnin mesazhe senzibilizuese nga përfaqësuesit komunal, anëtarët e Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje, dhe Shoqëria Civile, ku qëllimi kryesor ishte të promovohet familja dhe të mbrohen vlerat e saj si njësi bazë e shoqërisë.

Pjesëmarrja në punëtorinë 3 ditore, 24-26 maj në Shkup për ndërtim kapacitetesh dhe shkëmbim eksperiencash në mes të pjesëmarrësve të komunave të Kosovës dhe përvojave të mira me komunat e Maqedonisë së Veriut që ka të bëjë me buxhetimin e ndjeshëm gjinor për zbatimin e drejtë dhe efikas të parasë publike sipas parimit të barazisë gjinore dhe trajtimit të njëjtë të kërkesave të grave dhe burrave në nivel komunal. Pas mbajtjes së punëtorisë, është bërë analiza e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe janë përgatitë objektivat për vitin 2024, të cilat janë përfshirë në Kornizën Afatmesme Buxhetore, dhe pritet të miratohet në Kuvend Komunal.

ZBGJ përgatiti raportin vjetor për Agjencinë për Barazi Gjinore në zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore për vitin 2022, ku janë përshkruar veprimet institucionale të përcjella me alokimin e fondeve buxhetore për integrimin e perspektives gjinore në politikë-bërje, si një proces i domosdoshëm që ka për qëllim përmirësimin e jetës së vajzave dhe grave, djemve dhe burrave në komunë.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në mbështetje dhe bashkëpunim me Këshillin e Evropës Zyra në Prishtinë, organizoi lansimin e kursit për mbrojtje nga diskriminimi dhe punëtorinë për mbledhjen e të dhënave në zbatim të Ligjit 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, me ç 'rast ZBGJ mori certifikatë nga Këshilli Evropës për rezultatet që tregoi në fushën e të drejtave te njeriut dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Njësia për të Drejtat e Njeriut gjatë periudhës gjashtëmujore bashkëpunoi me drejtorët komunal, organizatat vendore e ndërkombëtare në koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve, sigurimin e burimeve financiare dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

**Aktivitete për të drejtat e fëmijëve**

Trajnim me Asamblenë Komunale të Fëmijëve-AKF dhe përfaqësuesit e grupit Respect Our Rights ROR në Gjilan në "Metodologjitë praktike të avokimit dhe rritja e përgjegjësisë dhe transparencës së institucioneve". Ky trajnim ka për synim ngritjen e kapaciteteve në fushën e avokimit ku përfaqësohet zëri dhe interesi me i mirë i fëmijëve nga Asambletë Komunale të fëmijëve dhe grupi ROR dhe rritjen e përgjegjësisë e transparencës së institucioneve gjegjëse në komunë dhe qeveri. Trajnimi është organizuar në kuadër të

programit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe qeverisjes me të drejtat e tyre "Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijëve dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës" i cili zbatohet nga organizata Syri i Vizionit në partneritet me Save the Children, zyra në Kosovë, dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar.23

Asambleja e fëmijëve në Gjilan në bashkëpunim me QKD-Pema, shënuan "1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve" me aktivitete senzibilizuese në mbrojtje të të drejtave të tyre. Përmes punimeve artistike shumëngjyrëshe, fëmijët kërkuan realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj.

## NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË KOMUNËN E GJILANIT

**1. Përshkrim i shkurtër i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm:**

- Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Ligji nr.06/L-21), si njësi e pavarur e auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik (Kryetarit të Komunës). Pra i raporton drejtpërdrejt vetëm Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik dhe e njofton Komitetin e Auditimit.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm, është e plotësuar sipas kërkesave ligjore, ashtu që për vitin aktual funksionon me tre auditor, të cilët janë të certifikuar sipas kushteve të parapara me ligj;
- Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm;
- Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar në të gjithë dokumentacionin e Subjektit të Sektorit Publik (SSP) ku funksionon.

Pra, Njësia e Auditimit të Brendshëm, funksionon në bazë të kornizës ligjore të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kornizës profesionale të vendosur nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), që mbështet vlerat kryesore të ligjshmërisë, integritetit, objektivitetit, besueshmërisë, kompetencave dhe pavarësisë.

**Misioni i Auditimit të Brendshëm** është që në pajtim me qëllimet e Institucioneve dhe organeve komunale:

- Të shtoj vlerën për performancën e veprimeve të Komunës duke siguruar cilësi dhe duke kryer auditime dhe shërbime këshillimore me kosto të reduktuara.
- Të sjellë përfitime në efiçiencen operacionale, kontrolle të brendshme dhe politika të përmirësuara.

**Qëllimet e Auditimit të Brendshëm janë:**

- Të jap siguri objektive, të pavarur dhe aktivitet këshillimor, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e Institucioneve dhe Organeve Komunale.

- Të asistoi të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre me anë të vlerësimeve të pavarura, këshillimeve dhe rekomandimeve.
- Të raportoi te menaxhmenti i lartë, lidhur me veprimet korrigjuese të ndërmarra nga të gjitha nivelet e menaxhimit.

**Objektiva e Auditimit të Brendshëm:**
Objektivi primar është të asistoi në menaxhimin e drejt të buxhetit, në zbatueshmërinë e plotë ligjore, në realizimin efektiv të përgjegjësive të tyre (personelit përgjegjës për ato veprime). Në këtë mënyrë i furnizon ata me analiza, rekomandime, këshilla dhe informacione lidhur me aktivitetet e shqyrtuara.

**2. Të Arriturat:**

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) punën e vetë e ka bazuar në Planin Strategjik për vitet 2023-2025 dhe Planin Vjetor për vitin 2023. Plane këto të shqyrtuara dhe aprovuara nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit.
Në Planin Vjetor të NJAB-së janë planifikuar që brenda vitit 2023 të kryhen gjithsejtë 10 auditime.
Brenda gjashtë mujorit të parë /2023 (deri me 30.06.2023), NJAB-ja ka përfunduar dy auditime (në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim dhe në NPL"Tregu". Kurse auditimi i tretë - auditimi i performancës për menaxhimin e subvencioneve deri me 30.06.2023 ka qenë në fazën e Raportimit.

Në dy auditimet e kryera janë dhënë **nëntë** rekomandime (**tri** rekomandime në auditimin e kryer në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim dhe **gjashtë** rekomandime në auditimin e kryer në NPL"Tregu". Prej tyre dy rekomandime kanë qenë të përsëritur (nga auditimi i mëparshëm në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim), ndërsa shtatë rekomandime janë dhënë të reja.
Tri rekomandimet e dhëna në auditimin e kryer Drejtorinë për Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim kanë pasur të bëjnë me:
- Krijimin e mekanizmave të rregullt për evidentimin në shërbimin e kontabilitetit (te zyrtari për të hyra) të gjitha Kontratat, Vendimet, apo Lejet e ndryshme të lëshuara për subjektet afariste të cilat sipas këtyre (Kontratave, Vendimeve, apo Lejeve të ndryshme) krijojnë obligime financiare ndaj Komunës. Kështu kishte me u evituar rreziku i ikjes nga pagesa e subjekteve afariste të cilat kanë shfrytëzuar hapësirat publike ndër vite.
- Me rritjen e angazhimeve të menaxhmentit për inkasimin më të madh të borxheve nga vitet paraprake dhe të vitit aktual të krijuara nga shfrytëzimi i hapësirave publike, por edhe nga qiraja.
- Marrjen e veprimeve administrative për definimin e qartë të mënyrës dhe nevojave të shfrytëzimit të hapësirave publike.

Kurse në auditimin e kryer te NPL"Tregu" të gjashtë rekomandimet kanë pasur të bëjnë lidhur me përmirësimin e proceseve brenda ndërmarrjes, duke filluar nga procesi i inkasimit të mjeteve, përmirësimi i evidencës kontabël dhe financiare, ndarja e drejtë e detyrave dhe përgjegjësive të punëtorëve administrativ, si dhe për rritjen e performancës menaxheriale.

**Zbatueshmëria e rekomandimeve të dhëna, do të sjellë efekte pozitive:**

- në menaxhimin më të mirë të hapësirave publike të dhëna në shfrytëzim, duke i rritur të hyrat, si dhe duke e ruajtur imazhin dhe reputacionin e Komunës.
- Në përformancën menaxheriale të NPL "Tregu" duke arritur rezultate më të mira afariste, ku do të krijoheshin mundësitë për zgjerimin e aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët dhe për Komunën si aksionare e NPL "Tregu".

Sa i përket auditimit për menaxhimin e subvencioneve në kuadër të komunës, (i cili auditim është në fazën e raportimit), duhet thënë se ky auditim në kuadër të fushëveprimit përfshinë të gjitha drejtoritë komunale të cilat kanë menaxhuar me subvencione, por fokusim të veçantë ka pasur për tri drejtori: Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Kjo është edhe arsyeja se procesi i këtij auditimi ka zgjatur më shumë se koha e planifikuar me Plan Vjetor të NJAB-së për vitin 2023.

**Aktivitetet e tjera të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në kuadër të Komunës (shkurtimisht)**

- Në fillim të vitit 2023 janë përgatitur dy raporte të punës së NJAB-së, raporti për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022 dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2022.
- Janë mbajtur dy takime me Komitetin e Auditimit (me 08.02.2023 dhe me 22.05.2023), ku është bërë shqyrtimi i raportit për gjashtëmujorin e dytë, raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2022 dhe aktiviteteve tjera të NJAB-së të kryera deri me 30.04.2023.
- Kemi pasur konsulta me auditorët e ZKA-së gjatë periudhës sa ata kanë qenë duke audituar.
- Edhe këtë vit drejtori i NJAB-së ka ndihmuar Komisionin për plotësimin e Pyetësorit të vet-vlerësimit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, ku është bërë një Informatë për Kryetarin e Komunës dhe Komitetin e Auditimit, lidhur me punën e këtij Komisioni dhe rishikimin e Pyetësorit.
- Në bashkëpunim me ekspertin e angazhuar nga USAID, kemi pasur angazhime në përgatitjen e draft-planit për integritet komunal 2023-2027.
- Me 21 mars drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm me ftesë të BIRN Kosova në kuadër të një projekti me USAID ka bërë një prezantim para 20 gazetarëve të cilët ishin duke e përcjellë Shkollën për hulumtime gazetareske në prokurimin publik në Hotel

"Astoria" në Gjilan. Prezantimi është bërë lidhur me përvojën dhe punën e Njësisë së Auditimit të Brendshëm si shumë e rëndësishme për një institucion, ashtu që është vlerësuar si e rëndësishëm edhe për gazetarët që të dinë punën e kësaj Njësie.

- Në pjesën e dytë të muajit prill 2023 kemi bërë një rishikim të zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në katër auditimet e kryera në tremujorin e katërt të vitit 2022 (*auditimi në Sektorin e Tatimit në Pronë, auditimi i Menaxhimit të Pasurisë Komunale, auditimi në NPL"Stacioni i Autobusëve dhe auditimi me kërkesë të kryetarit në drejtorinë e Inspeksionit*), ku për mesë një Informate me 28.04.2023 është njoftuar kryetari i Komunës, e më vonë është diskutuar edhe në Takimin e Komitetit të Auditimit.
- Kemi përcjellë pjesërisht Seancat e K.K.Gjilan, ku për rend të ditës kanë qenë tema që kanë qenë të nevojshme për punët audituese (*si Raporti i Pasqyrave Financiar për vitin 2022, bartja e disa mjeteve financiare nëpër kode tjera, Raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2023, ndryshimi apo shfuqizimi i ndonjë Vendimi, si dhe diskutimet lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore, etj*).
- Gjithashtu kemi pasur aktivitete lidhur me ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për disa drejtori komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë. Vlen të ceket se kemi pasur disa takime me zyrtarë të QKMF-së lidhur me të gjeturat në auditimin e menaxhimit të pasurisë komunale të përfunduar krejt në fund të vitit 2022, me zyrtarët për regjistrimin e të hyrave, me menaxhmentin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, menaxhmentin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe menaxhmentin e Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim.

**3. Sfidat:**

Sfidë kryesore ka qenë realizimi i auditimeve sipas Planit Vjetor, ku përkundër angazhimeve tona kemi pasur tejkalim të ditëve të planifikuara për auditime për të tri auditimet. E sidomos duhet të përmendim vështirësitë fillestare gjatë auditimit në NPL "Tregu", të cilat vështirësi kanë ndikuar në zgjatjen e auditimit edhe pas 31 marsit deri kur ka qenë planifikuar përfundimi i këtij auditimi. Kryesisht ka qenë mos respektimi i faktorit kohë nga zyrtarët përgjegjës për ofrimin e dokumentacionit të nevojshëm për analiza të auditimit.

Gjithashtu, tejkalim të ditëve të planifikuara për auditim ka pasur edhe në auditimin e performancës për menaxhimin e subvencioneve, sepse pos fushëveprimit të zgjeruar në këtë auditim janë angazhuar të tre auditorët njëkohësisht, e jo si herëve të tjera në dy auditime njëkohësisht.

**4. Punët kryesore në vazhdim:**

- ✓ Në pjesën e parë të muajit korrik kryesisht angazhimet e NJAB-së do të jenë në përfundimin e auditimit të performacës për menaxhimin e subvencioneve dhe verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dalura nga dy auditimet e kryera në këtë gjashtëmujor.
- ✓ Do të bëhet Rishikimi i Planit Vjetor të NJAB-së për vitin 2023.
- ✓ Deri me 15.07.2023 do të përgatitet Raporti i punës së NJAB-së për gjashtëmujorin e parë/2023.

- ✓ Do të raportohet para Komitetit të Auditimit për angazhimet brenda gjashtëmujorit të parë/2023.
- ✓ Më pastaj do të vazhdohet me angazhime konkrete sipas Planit Vjetor të rishikuar (pas aprovimit nga Kryetari i Komunës dhe nga Komiteti i Auditimit).

## ZYRA LIGJORE

Po ju ofrojë raportin e punës së **Zyrës Ligjore** për periudhën janar –qershor **2023.**

Aktivitetet në kuadër të Zyrës ligjore:

1. Projekt - kontratë/marrëveshje mirëkuptimi, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-40
2. Vendime të hartuara, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-92
3. Përgjigje në shkresa/kërkesa/ankesa -4
4. Qarkore ligjore-/
5. Opinione ligjore-3
6. Konsultime/këshilla ligjore-juridike-11
7. Shkresa/njoftime dërguar organeve dhe institucioneve lokale dhe qendrore -4
8. Urdhëresa të hartuara -/
9. Debate/Dëgjime publike për akte të ndryshme-/
10. Pyetësor/2
11. Autorizime 3

Ne kuadër te zyrës Ligjore janë lekturuar 542 faqe, gjithsej 141 dokumente të ndryshme në këtë periudhë janar-qershor -2023.

## Zyra e Avokatit të Komunës

**Të pranuara:**

- Padi kundër Komunës -219,
- Përgjigje në padi – pala -1,
- Aktgjykime– aktvendime të gjykatës themelore - 553,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës së Apelit - 267,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës Komerciale - 4
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës Supreme - 17,

- Pranimi i thirrjeve për seancë – 195,
- Ankesa palës- 88,
- Fjalë përfundimtare – 5,
- Konkluzion –konstatim – 6,
- Njoftime – 5,
- Parashtresa të palëve – 26,
- Përgjigje në ankesë të palëve – 34,
- Ekspertiza – 83,
- Revizion - pala – 4,
- Propozim për përmbarim palës – 177,
- Urdhër – 10,
-Mbrojtje të ligjshmërisë -1,
-Përgjigje në revizion – 2.

**Aktivitetet e zyrës:**

- Seanca gjyqësore në çështje juridike të ndryshme - 292,
-Padi – 1,
- Përgjigje në padi -219 ,
- Fjalë përfundimtare - 29,
- Ankesa - 98 ,
- Përgjigje në Ankesë - 62,
- Kundërshtime / Prapësime – 7 ,
- Parashtresa - 36,
- Kërkesa - njoftime drejtorive (email) – 112,
- Propozim për përmbarim - 2,
-Revizion – 4,
-Përgjigje në revizion -2.

**Gjithsej aktivitete – 2.561**

## ZYRA PËR INFORMIM

Zyra për Informim përbën një segment të rëndësishëm brenda qeverisjes komunale, që përmes informacioneve ditore, raporteve, njoftimeve e publikimeve të tjera, realizon transparencën e pushtetit kundrejt publikut, i cili ka të drejtë të plotë të njihet me punën e të zgjedhurve të vetë.
Gjatë këtij gjashtëmujori, Zyra ka përgatitur dhe publikuar në web faqen e Komunës dhe profilin e saj në facebook si dhe ka shpërnda për media mbi 170 informacione ditore, duke bërë kështu të mundur që puna e institucioneve vendimmarrëse dhe ekzekutive të jenë sa më transparente.
Në ueb faqe, pos informacioneve ditore janë publikuar edhe 380 materiale të tjera, si vendime të Kuvendit Komunal, rregullore, raporte, procesverbale, paralajmërime të seancave të Kuvendit si dhe aktiviteteve të tjera të ndryshme.
Në funksion të transparencës, po ashtu janë bërë publike dhe vendimet e Kryetarit të Komunës – 287 sish për këtë periudhë.
Si zakonisht, Zyra për Informim është kujdesur edhe për azhurnimin e rregullt të web-faqes komunale.
Po ashtu, në këtë gjashtëmujor, Zyra, në koordinim me Kabinetin e Kryetarit, ka ftuar gazetarët në konferencat e kryetarit të Komunës, si dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me mediat lokale e qendrore, në funksion të bashkëpunimit dhe transparencës.

## ZYRA KOMUNALE PËR INTEGRIME EVROPIANE

Zyra Komunale për Integrime Evropiane gjatë periudhës janar – qershor 2023, ka zhvilluar një varg aktivitetesh që dalin nga obligimet dhe përgjegjësitë e saja. Ky raport përfshinë aktivitetet dhe rezultatet e punës së kryer në një hark kohor prej gjashtë muaj te vitit 2023.
ZKIE është angazhuar në detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës përfshirë këtu komunikimin e rregullt me Kabinetin e kryetarit të Komunës, ministrinë e linjës dhe institucionet tjera që ndërlidhen me funksionimin sipas detyrave ditore, si dhe me akterët tjerë relevantë në realizimin e punëve dhe përgjegjësive që dalin në kuadër të ZKIE.
Fokus kryesor gjatë këtij gjashtë mujori ka qenë raportimi në kuadër të matricës lidhur me obligimet e Komunës nga agjenda evropiane për vitin 2022 si dhe gjashtë mujori për periudhën janar-qershor 2023, për të cilën kemi raportuar me kohë dhe kemi nxjerrë sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Gjilanit në këtë rrafsh. ZKIE e ka njoftuar kryetarin e Komunës, drejtoritë, zyrat dhe njësitë lidhur me të gjitha sfidat, në kuadër të obligimeve të Komunës që dalin nga agjenda Evropiane.
ZKIE, në vazhdimësi ka bërë identifikimin e sfidave që dalin nga raportimi për Agjendën Evropiane, koordinimi i vazhdueshëm me Zyrën e kryetarit, drejtoritë, njësitë dhe zyrat komunale lidhur me harmonizimin për eliminimin e sfidave që dalin nga Agjenda Evropiane. Për këtë, ZKIE ka raportuar në Bordin e drejtorëve, në prezencën e kryetarit të Komunës, ku janë njoftuar edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë për sfidat në fjalë.

Gjatë periudhës janar – qershor 2023, ZKIE ka bërë monitorimin e vazhdueshëm të seancave të Kuvendit Komunal si dhe komiteteve, detyrë e përshkruar me vendin e punës, si dhe takimet e vazhdueshme me komisionin komunal për riatdhesim në kuadër të kërkesave të qytetarëve të riatdhesuar në komunën e Gjilanit.

Udhëheqësi i ZKIE është i ngarkuar edhe me këto detyra shtesë, të cilat i realizon në përputhje me përshkrimet në vendimet e kryetarit:

- Zyrtar kontaktues në Agjencinë Kundër Korrupsion
- Zyrtar kontaktues për bashkëpunim ndër komunal dhe ndërkufitar
- Anëtar i grupit punues për hartimin e Planit Lokal për Riintegrim
- Anëtar i Komisionit Komunal për Riintegrim
- Zyrtar ndërlidhës komunal për diasporën
- Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale

Gjatë muajit janar – shkurt, është bërë identifikimi i zyrtarëve të lartë publikë, të cilët më herët nuk kanë qenë në listën e zyrtarëve për deklarim të pasurisë, por me Ligjin e ri obligohen ta bëjnë këtë.

Ndërsa, gjatë muajit mars, janë njoftuar të gjithë zyrtarëve të lartë për deklarimin e rregullt të pasurisë, ku përfshihen dhjetëra njoftime e takime informuese lidhur me mënyrën e deklarimit të pasurisë.

Misioni i Zyrës për integrime evropiane është që në bashkëpunim me instancat përkatëse lokale dhe qendrore, të mbështesë Komunën në arritjen e standardeve evropiane dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian si dhe të koordinojë të gjithë çështjet lokale të procesit të integrimit evropian, përmes respektimit të praktikave dhe rregullave të përcaktuara nga BE-ja.

## ZYRA E PROKURIMIT

Ky raport paraqet të dhënat për kontratat publike, ndarja e tyre mbi bazën e llojit të procedurave të përdoruara nga autoritetet kontraktuese, nivelin e përdorimit të këtyre procedurave, nivelin e konkurrencës brenda tregut publik duke ofruar bazën ligjore në mbështetje të shpenzimeve në mënyrë të duhur të parasë publike, si dhe indikator tjerë të rëndësishëm për matjen e performancës së prokurimit publik në Komunën e Gjilanit.

### 1.Ngjarjet kryesore gjatë këtij raporti

Më datën 16.01.2023, është dorëzuar në AQP Planifikimi Final i Prokurimit, pas dorëzimit te Planifikimit në AQP, kemi korrigjuar edhe njëherë Planifikimin e Prokurimit Publik për vitin 2023, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal, duhet të dorëzohet me shkrim Planifikimi Final i Prokurimit në AQP.

**2. Aktivitetet e kryera gjatë periudhës 2022- 2023 ( kontratat e nene shkruar )**
**1.** Ndërtimi i Parkut Baja - Ri Tender
**2.** Asfaltimi i rrugëve në lagjen " Livadhet e Arapit "
3. Rruga Jonuz Tërstena 28 Nëntori dhe krahët

**2.1 Zhvillimi i procedurave të prokurimit vitit 2022**

Gjatë kësaj periudhe, 49 aktivitete të prokurimit janë zhvilluar bazuar në Planifikimin Final të Prokurimit, duke respektuar hapat në vijim sipas Udhëzuesit Operativ për prokurim publik:

- pranimi i kërkesës për inicim dhe Deklaratën e Nevojave
- parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i kontratës
- përcaktimi i Procedurës së Prokurimit
- përgatitja e Dosjes së Tenderit
- publikimi në web faqe të KRPP
- hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve
- njoftimi për dhënie dhe nënshkrimi i Kontratës
- menaxhimi i Kontratës

**Njoftimet e Publikuara**

Departamenti i Prokurimit si përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të Autoritetit Kontraktues –Komunës së Gjilanit, sistematikisht është angazhuar për të procesuar të gjitha kërkesat e pranuara nga Njësitë e kërkesës, duke i zhvilluar aktivitetet sipas llojit dhe procedurave përkatëse të prokurimit.
Gjatë kësaj periudhe janë udhëhequr 42 aktivitetet të prokurimit, prej tyre:

1. Procedurë e hapur 45 aktivitete
2. Vlera minimale 10
3. Një procedurë e negociuar- 2- punë shtesë
4. Procedura me minitender - 1 aktivitete
5. Ankande publike -1

Nga këto aktivitete të zhvilluara kemi pasur 1 Ri tenderim

Prej të gjitha këtyre aktiviteteve të zhvilluara kemi pasur tri ankesa në OSHP, ku në katër raste është vërtetuar vendimi i Autoritetit kontraktues dy raste është kthyer lënda

Anulim i aktiviteteve të cilat ishin në OSHP

1. Furnizim me pelet Ri- tender
2. Furnizim me makinë për larjen e rrobave (industriale ).Ri ri-Tender
3. "Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese "
4. Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavorr
5. Ekzaminimi me material ndërtimore dhe shqyrtime gjeomekanike
6. Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit – Lot1 deri në Lot 4
7. Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi – Gjilan – para hapjes së ofertave
8. Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikes në rr. Adem Jashari- para hapjes së ofertave

| Nr. ren | Aktiviteti i prokurimit | Nr. prokurimit | Vendi i OSHP-s |
|---|---|---|---|
| 1. | ‘’ Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish ” | 651-22-11628-5-2-1 | Në rivlerësim |
| 2 | Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë | 651-22-11127-5-1-1 | anulim |
| 3 | Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri –Ri-Tender | 651-22-12442-1-1-1 | Ri vlerësim |
| 4 | Furnizim me Gjenerator | 651-22-12442-1-1-1 | Vendimi në favor te AK |
| 5 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikes në rr. Adem Jashari | 651-23-2715-5-2-1 | OSHP |
| 6 | Zgjerimi i rrugës Hamdi Kurteshi - Gjilan | 651-23-3604-5-1-1 | OSHP |
| 7 | Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit | 651-22-10313-2-1-1 | Ri vlerësim |

| RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 14 | 15 | 19 |
| 1 | 651-23-782-5-5-8 | Furnizim me pemë dhe perime për Çerdhet dhe Konviktin | 26.12.2019. | | 23.3.2023. | 20.3.2023. | 20,910.00 | 16,471.67 | Beni Dona Plast SH.P.K. |
| 2 | 651-23-608-2-4-7 | Sherbime të Avokatisë dhe përfaqësimit ligjorë- Ri Tender | 4.1.2023. | | 16.2.2023. | 7.2.2023. | 999.00 | 994.00 | Bardhosh Dalipi B.I. |
| 3 | 651-22-11519-5-2-1 | Ndërtimi i Parkut Baja - Ri Tender | 21.7.2022. | 21.10.2022. | 21.2.2023. | 14.2.2023. | 249,989.50 | 246,296.38 | Grup i Operatorëve Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K. |
| 4 | 651-23-1019-1-4-7 | Furnizim me Lule | 14.2.2023. | | 24.2.2023. | 16.2.2023. | 995.00 | 980.00 | Lulishtja Mani SH.P.K. |
| 5 | 651-23-427-1-2-1 | Furnizim me makina industriale për Pastrimin e Dyshemes | 19.1.2023. | 8.2.2023. | 23.3.2023. | 20.3.2023. | 12,000.00 | 8,670.00 | N.P.T. " Bajra " |
| 6 | 651-22-11197-5-2-1 | Asfaltimi i rrugëve në lagjen " Livadhet e Arapit " | 2.8.2022. | 15.11.2022. | 27.3.2023. | 23.3.2023. | 301,580.00 | 250,100.71 | TALI SH.P.K. |
| 7 | 651-22-11278-5-2-1 | Rruga Jonuz Terstena 28 Nëntori dhe krahët 1-5 | 2.8.2023. | 10.11.2022. | 27.3.2023. | 23.3.2023. | 308,100.00 | 266,709.57 | TALI SH.P.K. |
| 8 | 651-23-811-1-2-1 | Furnizim me farë misri | 6.2.2023. | 13.2.2023. | 3.4.2023. | 30.3.2023. | 25,000.00 | 22,320.00 | Agro Gresa SH.P.K. |
| 9 | 651-23-215-1-1-1 | Furnizim me material shpenzues laboratorik | 11.1.2023. | 25.1.2023. | 3.4.2023. | 31.3.2023. | 72,550.00 | 52,245.45 | "BIO-LAB" SH.P.K. |
| 10 | 651-23-215-1-1-1 | Furnizim me material shpenzues laboratorik | 11.1.2023. | 25.1.2023. | 3.4.2023. | 31.3.2023. | 72,550.00 | | "BIO-LAB" SH.P.K. |
| 11 | 651-23-215-1-1-1 | Furnizim me material shpenzues per aparatin biokimik dhe hematologjik | 11.1.2023. | 25.1.2023. | 3.4.2023. | 31.3.2023. | 53,570.00 | 46,664.15 | "BIO-LAB" SH.P.K. |
| 12 | 651-23-215-1-1-1 | Furnizim me material shpenzues per aparatin biokimik dhe hematologjik | 11.1.2023. | 25.1.2023. | 3.4.2023. | 31.3.2023. | 53,570.00 | | "BIO-LAB" SH.P.K. |
| 13 | 651-23-395-1-3-6 | Furnizim me sistemin e kamerave digjitale në QKMF,QMF dhe AMF | 19.1.2023. | 31.1.2023. | 13.4.2023. | 7.4.2023. | 7,897.00 | 6,953.70 | " Matrix IM " SH.P.K. |
| 14 | 651-23-2911-2-4-7 | Hartimi i projektit per aneksin e garazhave per NJPZSH-ne, Gjilan. | 13.3.2023. | | 13.4.2023. | 6.4.2023. | 999.99 | 980.00 | ENI Design SH.P.K. |
| 15 | 651-23-3181-1-4-7 | Furnizim me pesticide, farishta dhe repromaterial për pemishte dhe sera për nevojat e shmat Sahit Baftiu | 6.3.2023. | | 19.4.2023. | 7.4.2023. | 999.00 | 996.56 | Hakim Rasimi B.I. |
| 16 | 651-23-2247-1-3-6 | Furnizim me Batanije dhe Qerqaf për QKMF-në | 21.2.2023. | 23.3.2023. | 1.5.2023. | 27.4.2023. | 9,980.00 | 6,222.00 | Agron Commerce SH.P.K. |
| 17 | 651-22-12818-5-2-1 | Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos | 27.10.2023. | 15.11.2022. | 8.5.2023. | 4.5.2023. | 35,706.98 | 42,339.11 | EL-BAU SH.P.K. |
| 18 | 651-23-784-1-2-1 | Furnizim me pako ushqimore për familjet skamnore-DSHMS ( Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale ) Gjilan. | 18.1.2023. | 21.2.2023. | 11.5.2023. | 5.5.2023. | 30,000.00 | 24,500.00 | Dauti Komerc SH.P.K. |
| 19 | 651-23-4345-1-4-7 | Furnizim me mjete higjenike | 27.4.2023. | | 11.5.2023. | 5.5.2023. | 990.00 | 537.90 | Offishop Group SH.P.K. |
| 20 | 651-23-1266-5-2-1 | Renovimi i Parkut Egzistues afër stadiumit ndihmës të futbollit | 15.2.2023. | 27.3.2023. | 16.5.2023. | 12.5.2023. | 33,094.72 | 42,591.88 | Grup i Operatorëve Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K. |
| 21 | 651-23-2638-5-3-5 | Terenet sportive në shkollat e Komunës së Gjilanit- Ndarja në Lote –Ri tender" Lote 3."Sh.f.Bajram Curii-Shurdhan." | 1.2.2023. | | 17.5.2023. | 12.5.2023. | 5,890.12 | 5,890.12 | Grup i Operatorëve Ekonomik Globi - M.I. SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K. |